



**KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN**



**R A P O R T
I PUNËS I ZYRËS SË KRYETARIT DHE
DREJTORATEVE KOMUNALE
JANAR – DHJETOR
2020**

Mars, 2021

PËRMBAJTJA

Përmbajtja.....	2
Fjala hyrëse e Kryetarit.....	3
Përmbledhje Ekzekutive.....	6

ZYRA E KRYETARIT

1. Zyra e Protokollit	6
2. Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore	6
3. Avokatja Publike Komunale	8
4. Sektori për Marrëdhënie me Publikun	9
5. Njësia për Auditim të brendshëm	11
6. Sektori i Personelit	13
7. Sektori pronësor – juridik	16
8. Zyra Lokale për Komunitete	17

DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	18
2. Drejtorati për Arsim	21
3. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	30
4. Drejtorati për Buxhet dhe Financa	33
5. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	47
6. Drejtorati i Inspektoriatit	51
7. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	54
8. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	64
9. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër	71
10. Drejtorati i Shërbimeve Publike	73
11. Drejtorati i Prokurimit.....	79
12. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari	85
13. Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim.....	88

FJALA HYRËSE E KRYETARIT

-Të nderuar këshilltarë, qytetarë, media, organizata vendore dhe ndërkombëtare dhe gjithë ju të pranishëm në këtë mbledhje të Kuvendit Komunal të Lipjanit, më lejoni që para jush të prezentoj raportin vjetor, Janar-Dhjetor 2020, të punës së zyrës së kryetarit dhe drejtorateve komunale.

-Raporti vjetor përmbanë rezultatet e arritura, vështëresitë dhe sfidat që kanë përcjellë punën tonë në periudhen raportuese.

-Viti 2020 mund të cilësohet vit i pandemisë COVID 19, që ka determinuar në njërën anë kufizime të veprimeve dhe aktiviteteve në të gjitha fushat dhe ka shtuar aktivitetet tjera të pa planifikuara që lidhen me menagjimin e pandemisë.

-Fillimi i muajit Mars 2020 në vendin tonë është shpallur gjendja emergjente shëndetësore dhe në këtë periudhë janë pezulluar e reduktuar shërbimet administrative dhe veprime tjera në kompetencë të pushtetit lokal.

-Angazhimi i kapaciteteve në Shtabin Emergjent komunal në të gjithë sektorët për të menaxhuar situatën me pandeminë ka prodhuar në njërën anë veprime të caktuara e të koordinuara me institucionet tjera lokale e qendrore dhe në anen tjetër kufizime në kapacitetet deri te kufizimi i lëvizjes së lirë.

-Inspektorati komunal në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe sektorët e tjerë të Shtabit Emergjent kanë koordinuar aktivitetet në menaxhimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19.

Padyshim, meritojnë mirënjohje të veçantë të gjithë akterët e menaxhimit të kësaj periudhe duke veçuar mjekët dhe stafin tjetër shëndetësor, Shtabin Emergjentë, Policinë e Kosovës, Bashkësinë Islame në Lipjan, Kryqin e Kuq në Lipjan dhe shumë donatorë dhe kontribues të tjerë për kontributin e dhënë gjatë kësaj periudhe.

-Aktivitetet e furnizimeve dhe veprimeve të nevojshme në të gjitha institucionet publike janë aktivizuar me kohë duke kryer shërbimet e nevojshme dhe furnizimet e institucioneve shëndetësore, arsimore, administrative, etj., në dobi të menaxhimit të pandemisë COVID-19.

-Janë bërë furnizimet me mjetet mbrojtëse dhe aparatura shtesë, duke shtuar kapacitetet në QKMF, duke shtuar mobilizim maksimal të gjithë stafit shëndetësor.

Prej fillimit të Pandemisë e deri në fund të vitit 2020, bazuar gjithnjë në rrezultatet e rregullta të IKSHPK-së, në Komunën tonë janë identifikuar 1388 raste pozitive, 1069 të shëruar, 26 të vdekur dhe 293 raste aktive.

-Me qëllim të menaxhimit të periudhës së pandemisë dhe ndihmës me pako higjienike dhe ushqimore janë ndarë 170,000.00 mijë euro dhe së bashku edhe me ndihmën e shumë donatorëve kemi shpërndarë mbi 6 mijë pako ushqimore, higjienike dhe produkte të tjera.

-Po ashtu me vendim të kuvendit kemi liruar nga pagesa e qirasë dhe shfrytëzuesit e hapësirave publike, përfituesit e banimit social, shfrytëzuesit e parkingjeve publike, janë liruar nga qiraja qiramarrësit e objekteve në pronësi të komunës, janë liruar nga participimi për shërbimet e ofruara në çerdhe publike për vitin 2020 etj. Gjithashtu janë subvencionuar edhe fëmijët pa përkujdesje prindërore.

-Përkundër të gjitha vështirësive të shfaqura duke i kushtuar prioritet shëndetit dhe menaxhimit të periudhës me COVID-19 ne kemi arritur ti procedojmë të gjitha projektet e parapara në këtë periudhë.

-Ne duhet të jemi koshient për vështirësitë në realizimin e planifikimit buxhetor, në veçanti të të hyrave vetanake të planifikuara dhe në realizimin e planit të shpenzimeve të parapara buxhetore, sepse impakti i kufizimit të aktiviteteve të bizneseve, pakoja emergjente dhe përgjithësisht efektet e pandemisë COVID-19 kanë rezultuar vështirësi në realizimin e agjendës sonë të paraparë buxhetore. Shpenzimi i buxhetit për vitin 2020 ka qenë në vlerë prej 17,752,037.71 euro ose shprehur në përqindje 88.89 %.

-Fillimi i procedurave sidomos në investimet kapitale ka pasur vështirësi në mungesë të aprovimit të buxhetit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për dy muajt e parë të vitit 2020. Po ashtu vonesa të theksueshme në kontraktimin e punimeve dhe shërbimeve sipas agjendës buxhetore ka determinuar edhe vendimi i KRPP-së për pezullimin e aktiviteteve në një kohë të caktuar gjatë këtij viti. Reduktimi i stafit dhe pezullimi i punës në administratë gjatë periudhës së pikut të pandemisë COVID-19 gjithësesi ka reflektuar me vonesa të caktuara në dinamikën e realizimit të projekteve. Megjithatë ne kemi arritur të realizojmë mbi 150 projekte në teren.

Investimet në rrugë, trotuare, ndriçim publik, kanalizime, ujësjellës, objekte e fusha sportive, në shkolla e ambiente shkollore, në lumenjtë dhe hapësira gjelbëruese si dhe në mirëmbajtjen e tyre edhe gjatë vitit 2020 padyshim përbëjnë pjesën kryesore të investimeve kapitale.

Këtu padyshim dua të veçoj projektet: Ndriçimi publik në rrugën e Lipjan –Magure që lidhë shumë fshatra, përfundimin e shtigjeve të ecjes në Lipjan, përfundimi i shkollës fillore në Magure, punimet në shtratin e Lumit Sitnica, çerdhja e re në Lipjan, salla e sporteve në Kraishtë, fillimi i ndërtimit të rrugëve siç janë rruga e Shkupit, rruga e Lumit në Gadime, rruga, transit e Lipjanit që lidhë lagjen e konjuhit dhe akllapit me rrugën rajonale Lipjan-Janjevë, fillimi i punimeve në rrugën Sllavi –Akllap dhe Lluga –Radevë. Një projekt tjetër me rëndësi të veçantë është përfundimi i punimeve në ujësjellësin e regjionit të Dobrajes si dhe fillimi i punimeve në ujësjellësin e regjionit të Kraishtës që pritet të përfundojë në vitin e ardhshëm. Po vazhdojnë punimet edhe në shumë projekte të tjera siç janë: Stadiumet në Lipjan, Dobrajë dhe Magure, palestra sportive dhe objekti i ri i Administratës së Komunës në Lipjan, shkolla e mesme në Gadime e shumë projekte të tjera që do të përfundojnë në vitin e ardhshëm.

Gjatë këtij viti gjithashtu janë nënshkruar edhe janë në proces edhe projekte të tjera që do të fillojnë në vazhdim të angazhimeve tona siç janë: fasadimi i objekteve shumë banesore në Lipjan, faza e dytë e shtigjeve të ecjes, shkolla fillore në Lipjan, çerdhja në Gadime etj.

Në fushën e arsimit, jemi angazhuar në vazhdimësi në krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit edukativo – arsimor. Shkollat tona tani janë të furnizuara me kabinete të TIK-ut, kabinete të fizikës, kimisë, biologjisë, me rekuizita sportive. Janë furnizuar 15 shkolla me 43,288 libra, furnizime me mjete higjienike dhe inventar etj.

Jam i kënaqur që këtë vit kemi gjetur mundësinë për ndarjen e 134 bursave për studentët e dalluar, me synim që çdo herë të shtojmë numrin studenteve që do të përfitojnë bursë nga komuna jonë.

Por për dallim nga vitet tjera ky vit ka qenë një sfidë dhe përvojë e re edhe për personelin arsimor, nxënësit ashtu edhe për prindërit ku viti shkollor 2019/2020 duke praktikuar edhe mësimin online për arsye të paraqitjes së pandemisë.

Subvencionet për sport, rini dhe kulturë janë dyfishuar në vitin 2020 me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të klubeve dhe OJQ-ve rinore, pavarësisht vështirësive këtë vit janë ndarë 135,000.00 euro subvencione, ndërsa puna ka vazhduar edhe në ndërtimin e stadiumeve, komplekseve sportive dhe hapësirave tjera rekreative për të gjithë.

Edhe në fushën e bujqësisë viti që lamë pas, ka shënuar rritje të subvencionimit të fermerëve ku kemi dyfishuar numrin e përfituesve të granteve.

Gjatë vitit 2020 janë shpërndarë 291 serra, 147 moto kultivator. Po ashtu në bashkëpunim në mes komunës dhe IADK-së, 11 fermerëve u janë shpërndarë mekanizma bujqësor.

Përkundër situatës me COVID 19 dhe me një staf të reduktuar që nga fillimi i vitit, Administrata komunale ka vazhduar të ketë performancë të mirë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në punën tonë objektivë e përhershme mbetet qeverisja e ligjshme, transparente dhe llogaridhënëse. Në kuadër të këtij objekti, primatin e punës sonë e ka fokusi në thellimin e bashkëpunimit me qytetarë dhe të gjithë akterët potencial në vendimarrje.

Komuna jonë është vlerësuar lartë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, të cilat merren me matjen e performancës komunale, ku për të tretën herë me radhë, Komuna e Lipjanit është renditur e para në matjen e mjedisit të favorshëm të të bërit biznes, nga USAID përmes Indeksit të Konkurrueshmërisë së Komunave për vitin 2020. Gjithashtu edhe në raportet dhe monitorimet siç janë: MAPL, KDI dhe Instituti GAP, komuna jonë renditet ndër komunat me performancë të lartë.

I nderuar Kryesues,

Të nderuar Këshilltar Komunal,

Të nderuar të pranishëm.

Padyshim viti 2020 është ndër vitet më sfiduese të qeverisjes lokale dhe para nesh vjen edhe me tutje sfida me më shumë të panjohura me pandeminë COVID-19. Pavarësisht këtyre sfidave unë ndjehem mirë për rezultate e arritura dhe dua të falënderoj të gjithë qytetarët e Lipjanit dhe partnerët vendor e ndërkombëtare për kontributet e përbashkëta gjatë vitit që lamë pas.

Duke ju uruar shëndet, ju ftoj të angazhohemi të gjithë së bashku në tejkalimin e sfidave dhe vështirësive tona, në dobi të progresit të gjithanshëm si dhe zhvillimin shumëdimensional të komunës sonë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raportin vjetor për vitin 2020, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja lokale. Ky raport është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2020 angazhim kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe disiplinës në punë. Në vazhdim po e paraqesim raportin për vitin 2020, raport ky që përmban informata për punën e Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha Drejtorateve dhe zyrave në kuadër të komunës.

ZYRA E KRYETARIT

ZYRA E PROTOKOLLIT

RËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Zyra e protokollit gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2020 është angazhuar maksimalisht për organizimin sa më të mirë të të gjitha aktiviteteve të organizuara nën patronatin e Kryetarit të Komunës si dhe organizimin e takimeve të ndryshme.

Për shkak të situatës së ballafaqimit me pandeminë COVID-19, disa takime të kryetarit janë organizuar përmes platformave online, ndërsa takimet e organizuara në zyrën e tij dhe në sallën e kuvendit janë zhvilluar konform rekomandimeve të IKSHPK-së.

Në vitin 2020, Zyra e Protokollit në Komunën e Lipjanit ka kryer këto punë:

- Organizimin e takimeve protokollare të kryetarit të komunës;
- Evidentimin dhe mbikqyrjen e takimeve të kryetarit të komunës;
- Përgatitjen e takimeve të kryetarit me delegacione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, nga niveli qendror dhe lokal;
- Organizimin e takimeve të kryetarit me qytetarët e komunës së Lipjanit;
- Organizimin e dy takimeve publike ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale;
- Organizimin e takimit virtual me qytetarët e komunës sonë përmes platformës “Fol hapur me kryetarin si dhe
- Bashkëpunim me drejtoratet e komunës për aktivitetet e organizuara nën patronatin e kryetarit.

SEKTORI PËR PËRFAQËSIM DHE ÇËSHTJE LIGJORE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese vazhdimisht është bërë përcjellja e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës.

Sipas kërkesave të Drejtorateve të komunës dhe sektorëve të komunës janë dhënë këshilla juridike në përgatitjen e akteve nga kompetenca.

Gjatë tërë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2020, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore pa lëndët e përfaqësimit nga kompetenca e Avokates publike komunale ka kryer punët në vijim:

Gjatë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit janë përgatitur Vendime, Shkresa të ndryshme, Marrëveshje, Kontrata, Urdhëresa , Leje Qarkullimi si dhe Propozim Rregullore dhe Propozim Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

STATISTIKAT

1.Aktet e përgatitura nga Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore për vitin 2020:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendimet	698
2.	Shkresat	367
3.	Marrëveshje	437
4.	Kontrata	12
5.	Urdhëresa	27
6.	Leje Qarkullimi	131
3.	Propozim Rregullore	5
4.	Propozim Vendime	18

TAKIME TË NDRYSHME

Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

SFIDAT

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur disa sfida dhe vështirësi të tejkalueshme kryesisht në udhëzimin e palëve për kompletimin e dokumentacionit gjatë parashtrimit të kërkesave drejtuar Kryetarit të Komunës si dhe në sjelljen e raporteve nga ana e përfituesve të subvencioneve mbi shpenzimin e mjeteve financiare.

AVOKATJA PUBLIKE KOMUNALE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

-Sipas lëndëve të pranuar nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve paraqesim raportin e punës me sa vijon:

-Lëndë të bartura nga vitet paraprake janë 414 lëndë, ndërsa të pranuar deri me dt.31.12.2020 janë 935, në procedurë kanë qenë gjithsej 1365 lëndë.

- Në procedurë janë 1071 lëndë
- Të përfunduara janë 272 lëndë

-Në procedurën administrative kemi bashkëpunuar me të gjitha drejtoratet komunale për sigurimin e provave materiale për seancat gjyqësore dhe kompletimin e lëndëve si dhe kemi dhënë edhe ndihma juridike kur kanë kërkuar drejtoratet përkatëse.

Punët dhe aktivitetet e realizuara:

-Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 300 seanca gjyqësore, kemi ushtruar 54 ankesa, 416 përgjigje në padi në procedurë civile, procedurë përmbaruese kemi ushtruar 517 prapësime, 241 ankesa, kemi ushtruar 8 propozime për ekzekutim tek përmbaruesit privat, 3 janë që kanë të bëjnë me tatimin në pronë si dhe mjetet e shpronësimit të pronës komunale dhe 5 janë për lokale afariste, kemi ushtruar dy padi në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe një propozim për caktimin e vlerës së pronës së vlerësuar nga MF-Departamenti për vlerësimin e pronave në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan, kërkesa –parashtresa tjera sipas nevojës në të gjitha procedurat.

-Si palë e dëmtuar kemi marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore në procedurë penale duke propozuar që kërkesa pasurore juridike të realizohet gjatë të njëjtës procedure për dëmin e shkaktuar për secilën lëndë.

Statistikat:

-Paraqesë skemën tabelave të lëndëve në procedura të ndryshme dhe at me sa vijon:

Nr.	Llojet e procedurave	Lëndë të bartura	Lëndë të Pranuar	Nr. i përgjithshëm i lëndëve	Lëndë në Gj.Th.P-Dega ne Lipjan – P.Privat	Lëndë në Gjykatë Apelit	Lëndë në Gjykatë Suprem	Lëndë Pcedur Administrative	Lëndë të Kryera	Lëndë në Procedurë
1.	Procedurë penale	15	1	16	/	/	/	/	1	15
2.	Procedurë civile	283	416	699	641	54	4	/	53	646
3.	Procedurë përmbaruese	131	517	648	407	241	/	/	223	425
4.	Procedurë administrative	2	0	2	/	/	/	/	1	1
5.	Gjithsejtë	431	934	1365	1048	295	4		278	1087

Në procedurë civile për lëndët e ish „Kosovatransit “ janë 10 lëndë që kërkojnë kompensimin e të ardhurave personale prej vitit 1990 deri 1999 duke u bazuar në Aktin për pranim dorëzim të ish„Kosovatransit “ në mes të AKP-së dhe Komunës së Lipjanit të nënshkruar në vitin 2012 dhe shuma e kërkuara për të gjitha lëndët është **113,335.43€**, e krejt kjo është si pasoj e pranimi të NP„Kosovatrans“ në Lipjan sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike dhe aktit të cekur ma lart. Lidhur me këtë çështje në procedurë është edhe një lëndë me numër të përgjithshëm të punëtoreve prej 83 punëtorë të cilët kërkojnë kthim në punë dhe kompensim e të ardhurave personale nga viti 1990 deri 1999.

-Në kontestet civile janë 699 lëndë prej tyre janë fituara 9 lëndë të humbura janë 44 lëndë ndersa të tjerat janë në procedurë, shuma e përgjithëshme për lëndë të fituara është **5,818,035.00€**

-**Në procedurë përmbarese** në vitin 2020 janë gjithsejtë 648 lëndë prej tyre janë ekzekutuara 223 lëndë në shumë prej **178,389.75€+ kamata dhe shpenzimet e procedurës**, ndërsa të pa ekzekutuar janë 425 lëndë dhe borxhi i mbetur i komunës-debitorit është **241,476.43 € + kamata dhe shpenzimet e procedurës** i cili borxh është i punëtorëve të arsimit – DKA, punëtorëve të shëndetësisë, shpronësim dhe OE.

-**Në procedurë penale** janë të përfunduara 2 lëndë ndërsa lëndë tjera që aktgjykimet janë bërë të plotfuqishme po nuk po ka mundësi të ekzekutohen për shkak të çështjeve të pa definuar në mes të MBZHR dhe komunës e që kanë mbetur pa u ekzekutuar ngase problemi kryesor qëndron se në kallëzimet penale është e shënuar llogaria e Agjencionit Pyjorë të Kosovës, kam biseduar me DBF por janë deklaruar se nuk ka kod të veçant për ekzekutimin e këtyre lëndëve,ndërsa të tjerat janë në procedurë, kjo çështje mbetet të rregullohet në mes të MBZHR- Agjencinë e Pyjorë të Kosovës dhe komunës së Lipjanit.

-Çështje tjetër që mbetet të rregullohet është edhe çështja e zjarrfikësve në mes të Komunës dhe MPB-Agjencinë e Emergjencës së Kosovës nga se është e definuar mire statusi i tyre se punëtorë të kujt janë.

SFIDAT:

-Gjatë periudhave raportuese të kaluara por edhe kësaj periudhe, kanë qenë sfidë kryesore që edhe kanë paraqitur problem gjatë mbrojtjes ligjore të interesave të Komunës, mungesa e dokumentacioneve nga arkiva dhe mangësia, vështirësitë për gjetjen e dokumenteve arkivore të viteve të paraluftës.

SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

-Sektori për Marrëdhënie me Publikun në vitin 2020 është angazhuar maksimalisht në realizimin e detyrave dhe përmbushjen e obligimeve në mënyrë që Komuna e Lipjanit të vazhdoj të jetë në mesin e komunave të para sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.

-Edhe në këtë vit, Komuna e Lipjanit ka qenë e hapur për qytetarë. Në web faqen zyrtare të Komunës janë publikuar materiale të ndryshme në mënyrë që qytetarëve tu ofrohen të dhënat e nevojshme. Kjo web faqe ka qenë edhe një udhëzim shtesë dhe transparent në të cilën janë publikuar të gjitha vendimet, shkresat, njoftimet, rregulloret, raportet e shpenzimeve financiare, kontrata, planifikimi i buxhetit, ndarja e subvencioneve si dhe shumë material të tjera.

-Po ashtu, edhe gjatë këtij viti me një transparencë të plotë janë zhvilluar punimet e të gjitha seancave të Kuvendit, të cilat janë transmetuar drejtëpërdrejtë në kanal zyrtarë të komunës në Youtube.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

-Gjatë vitit 2020, Sektori për Marrëdhënie me Publikun ka kryer punët në vijim:

-Është bërë përcjellja e aktiviteteve të kryetarit të komunës, aktiviteteve të tjera komunale brenda dhe jashtë komunës dhe pastaj përgaditja e lajmeve për publikim në web faqen zyrtare, rrjetet sociale si dhe në media të ndryshme;

-Sipas kërkesave të Drejtorateve dhe sektorëve të tjerë janë publikuar materialet e ofruara për zyrën e informimit;

-Janë publikuar në web faqe të gjitha vendimet e kryetarit, gjitha vendimet dhe rregulloret nga sektori i Kuvendit në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe; Publikimi i raporteve të drejtorëve për çdo muaj; Po ashtu janë publikuar në web faqe vendime, njoftime dhe konkurse të shumta të cilat janë ofruar në zyrën për informim; Konkursat me kërkesën e përgjegjësve janë publikuar në gazetën ditore.

-Gjithashtu është bërë publikimi i kontratave të prokurimit sipas kërkesës nga Drejtoria e Prokurimit, po ashtu është bërë edhe publikimi i vendimeve të OSHP-së dhe vendimet e autoritetit kontraktues. Në vitin 2020 janë vizituar të gjitha projektet që janë implementuar në terren dhe janë bërë fotografi për nevojat e zyrës si dhe të njëjtat janë arhivuar, ku po ashtu janë vizituar shumica punëve që janë bërë dhe janë duke u bërë në terren duke marrë pamje me kamerë për nevojat e zyrës për informim. Janë ofruar informata për gazetarë duke ju referuar kërkesave të tyre si dhe janë pranuar dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike. Është bërë përgaditja e Buletinit vjetor si dhe përgatitja e reportazhit për vitin 2020 si dhe punë të tjera që dalin në kuadër të zyrës për informim.

STATISTIKAT

-Sektori për Marrëdhënie me Publikun gjatë vitit 2020 ka publikuar rreth 300 lajme në web faqen e Komunës, kemi pranuar gjithësej 22 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe të gjithave u është lejuar qasja. Janë publikuar në web faqen dy raporte të kryetarit dhe plani i punës për vitin 2020, është bërë publikimi i mbi 370 vendimeve të kryetarit, janë publikuar 177 njoftime, 29 konkurse, 30 marrëveshje, 31 vendime të kuvendit 8 rregullore, 8 shqyrtime publike, të gjitha kontratat e nënshkruara nga Prokurimi, vendimet e OSHP-së dhe vendimet e Autoritetit kontraktues drejtuar operatorëve, pra rreth 853 dokumente të ndryshme të prokurimit, publikimi i të gjithë materialit për seancat e mbajtura në vitin 2020, procesverbalet nga mledhjet e Kuvendit Komunal si dhe materiale të tjera të ndryshme me interes për publikim, të cilat ka pranuar sektori ynë në vitin që lamë pas.

-Në web faqen e komunës po ashtu kemi publikuar çdo muaj edhe raportet e të gjitha drejtorateve komunale, rishikimin e buxhetit, ridestinimin e buxhetit, raportet e shpenzimeve, listën e oligimeve të komunës për çdo muaj si dhe Kornizen Afatmesme Buxhetor 2021- 2023.

Në vitin 2020 kemi filluar edhe me përgatitjen e Buletinit mujor ndërsa në fund të vitit, Sektori për Marrëdhënie me Publikun ka përgatitur 1 reportazh dhe 1 buletin.

TAKIME E NDRYSHME

-Kemi pasur takime të shumta me gazetarë nga mediet e ndryshme të shkruara dhe elektronike. Po ashtu takime janë zhvilluar edhe me përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që monitorojnë punën e Komunës së Lipjanit. Vitin 2020 takime kemi pasur edhe me qytetarë të cilët i janë drejtuar zyrës sonë për informata rreth komunes. Gjatë vitit ka pasur edhe trajnime dhe takime të tjera të organizuara me zyrtarët për informim dhe ku kemi marrur pjesë edhe ne. Kemi qenë pjesë e një takimi në Prishtinë të organizuar nga MAPL ku është diskutuar për plotësim ndryshimin e udhëzimit administrative për standarde minimale të Konsultimit Publik si dhe kemi zhvilluar disa takime në mënyrë elektronike shkaku i pandemisë COVID – 19. Vlenë të përmendet se shumica e takimeve të realizuara kanë qenë online për shkak të përballjes me pandeminë.

SFIDAT

-Në fillim të vitit sfidë që na ka përcjellur ka qenë problemet e shfaqura rreth funksionimit normal të web faqes zyrtare të komunës. Në një shkresë informuese nga MAPL jemi njoftuar se web faqet kanë kaluar në server të ri prandaj kemi pasur problem të tilla, të cilat janë tejkaluar dhe aktualisht web faqet janë duke funksionuar mirë. Po ashtu sfiduese gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe puna me staf të reduktuar shkaku i pandemisë COVID – 19.

NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

-Me aprovimin e ligjit mbi kontrollin dhe menaxhimin financiar me të cilin ishte ndryshuar koha e dorëzimit të planit vjetor të punës në Ministrinë e Financave pas aprovimit nga Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës , kështu është përpiluar Plan i Strategjik Trevjeçar 2020-2021 në të cilin janë paraparë Objektivat kryesore për një cikël trevjeçar të Auditimit për të gjitha fushat e Auditimit. -Pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë të identifikuar, është bërë rangimi i detyrave të punës të cilat janë auditive të rregullta të planifikuara, duke u bazuar në shkallën e rrezikut për fushat e identifikuar në Planin Strategjik dhe kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore të cilat i ka Njësia e Auditimit të Brendshëm.

-Në përputhje me Planin Strategjik për vitet 2020-2021, është hartuar edhe plani vjetor i punës për vitin 2020, ku janë planifikuar detyrat e punës për çdo entitet që do të auditohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në planin vjetor të punës detyrat janë planifikuar sipas muajve dhe fushëveprimit për secilin auditim të rregullt për NJAB-në.

-Plani strategjik dhe plani vjetor i punës janë aprovuar nga Komiteti i Auditimit dhe janë miratuar nga Kryetari i Komunës.

-Me Ligjin e Auditimit të Brendshëm nr 03/L-128, Komiteti i Auditimit është kompetentë për aprovimin e planeve të Njesisë së auditimit të brendshëm dhe raporteve të punës dhe ndërmjetësues në mes të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe ZKA me qëllim të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Njësia e auditimit të brendshëm.

-Pas raportimit të detyrave të kryera nga NJAB për vitin paraprak në fillim të vitit 2020 , në Komitetin e Auditimit , NJQHAB-në dhe Zyrës së Kryetarit , NJAB në bazë të planifikimi vjetor ka filluar të kryej detyrat e planifikuara në përputhje me planin vjetor të punës për vitin 2020 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera, pas pranimit të planit të zbatimit të rekomandimeve nga drejtorët e drejtorive ku është kryer auditimi dhe përmbajtjes së orarit për rishikim të cilin NJAB i dërgon me Raportin Final, ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim me të cilën ka njoftuar edhe ZKA –an lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga NJAB.

-Puna që është kryer gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, i referohet pikërisht përmbushjes së objektivave të parapara me këto Plane të cekura më lartë.

-Para se të paraqesim detyrat e kryera të NJAB-se, për çështje të raportimit duhet cekur se që nga data **13.03.2020** , kur janë identifikuar rastet e para të Pandemisë Covid -19, deri më datën **27.05.2020** kur Komuna ka punuar me staf të reduktuar, NJAB , nuk ka mundur ti kryej detyrat e veta sipas planit të punës. Me sugjerimet e NJQHAB –së kemi përgatitur ndryshimin e planit vjetor të punës dhe kemi prezantuar

para komitetit të Auditimit, pas takimit të mbajtur më 26.06.2020 është miratuar nga Komiteti i Auditimit: Ndryshimi i Planit të punës së NJAB-së dhe i njëjti është aprovuar nga Kryetari i Komunës.

PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2020 NJAB ka Finalizuar 8 Raporte të Auditimit të cilat janë kryer në këto entitete:

- Auditimi i procedurave të prokurimit për Vitin 2019 Fushëveprimi: 01.01.2019 - 31.12.2019.
- Auditimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë Periudha Janar 2019 -Janar 2020”
- Auditimi i Shpenzimeve në Drejtorinë e Shëndetësisë –QKMF periudha 01.10.2018 – 30.04.2020
- Auditimi i të Hyrave nga zyra për ofiqari (dokumentet e gjendjes civile)-Drejtoria e Administratës periudha 01.08.2018 – 31.12.2019
- Auditimi i të hyrave nga lejet ndërtimore ne Drejtorinë për Urbanizëm dhe mbrojtje të Mjedisit, periudha prej 01.08.2019 - 31.07.2020
- Auditimi i Projekteve kapitale në DHP (faza pas nënshkrimit të kontratës deri te pranimit teknik).
- Auditimi i Shpenzimeve në Administratën Komunale (13 programet buxhetore) prej 01.10.2019-30.09.2020
- Regjistrimi dhe Menaxhimi i Pasurive Komunale” për periudhën 01.11.2019 – 01.11.2020
- Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2020 , NJAB ka monitoruar edhe shkallën e implementimit te rekomandimeve te cilat janë dhënë me rastin e kryerjes së auditimeve të brendshme dhe për të cilat menaxhmenti (zyrtarët përgjegjës të entitete ku është kryer auditimi),ka përgatitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të NJAB-së
- Në këtë periudhë janë kryer edhe 9 Rishikime të auditimeve sipas orarit të paraparë për rishikim .
- Të gjitha raportet finale janë dorëzuar për përgjegjësitë e entiteteve të audituara dhe Zyrës së Kryetarit dhe Komitetit të Auditimit.

STATISTIKAT

-8 Auditime të rregullta të planifikuara janë përfunduar sipas planit vjetor të punës të ndryshuar për vitin 2020, dhe 9 Rishikime të Auditime të kryera më herët nga NJAB me qëllim të monitorimit të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe dërgimi informative të shkruara përgjegjëse të entiteteve të audituara dhe menaxhmentit (kryetarit të komunës) lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve.

-Eshtë mbajtur një trajnim me USAID –it me temën sigurimi i cilësisë së auditimit dhe Auditimet e performances .

-me DEMOSIN , janë mbajtur trajnime për pesë Module të menaxhimit financiar në fushat e identifikuara të cilat ndikojnë në ngritjen e performancës së Komunave për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-it

TAKIME E NDRYSHME

-Gjatë këtij viti janë mbajtur edhe pesë takime të rregullta me Komitetin e Auditimit ku janë shqyrtuar raportet e punës së NJAB-së për periudhat:

-**Takimi i parë** është mbajtur me komitetin në Muajin Janar 2020 ,për shqyrtimin e raporteve të punës së NJAB-së për periudhën TM4-2019,

-**Takimi i dytë** për raportin për Tremujorin e parë 2020 , (TM1-2020) , takimi është mbajtur në Muajin Qershor 2020 , gjithashtu pas përfundimit të raportit gjashtë mujor për NJQHAB,.

-**Takimi i tretë** me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e dytë(TM2-2020) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Gusht 2020 .

-**Takimi i katërt** me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e tretë(TM3-2020) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Tetor 2020 .

-Takimi i pestë me Komitetin e Auditimit për aprovimin e planit strategjik të NJAB-së për vitet 2021-2023 dhe planit vjetor punës për vitin 2021 është mbajtur më 21.12.2020 .

SFIDAT

-Pjesëmarrja në trajnimet të cilat organizohen nga IKAF lidhur e Auditimit e brendshëm me qëllim të plotësimit të obligimit ligjor për sigurimin e 20 orëve për EVP për auditorët e brendshëm.
-Situata me menaxhimin e Pandemisë dhe kufizimi i kontakteve me zyrtarët të cilët janë identifikuar me virusin Covid -19

SEKTORI I PERSONELIT

-Në kuadër të fushë veprimtarisë së saj dhe në përputhje me kornizat ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Lipjanit , është angazhuar në disa drejtime, si:

- Plotësimin e nevojave të administratës komunale për më shumë staf;
- Vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe koordinimin e trajnimeve të stafit me Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP);
- Hartimi i vendimeve dhe shkresave brenda fushëveprimit të Sektorit për Personel;
- Ofrimin e mbështetjes administrative (sekretari) për Komisionin Disiplinor;
- Raporte, analiza, statistika dhe shkresa sipas kërkesave të ndryshme ;
- Raporte, analiza, statistika dhe shkresa me kërkesë të Institucioneve Qendrore;
- Rregullimin dhe digjitalizimin e dosjeve të stafit dhe futjen në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) për të gjitha procedurat që kryen sektori për Personel;
- Procesin e riorganizimit të administratës komunale dhe sistematizimin e pozitive të nëpunësve (Vendimi mbi organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale,);
- Këshillon dhe mbështet udhëheqësit e njësive organizative të institucionit lidhur me përshkrimet adekuate të vendeve të punës;
- Planifikimi Buxhetor i Pagave për çdo vitë për nëpunësit e Administratës Komunal;
- Të tjera ndryshimet, transferimet, pagesat retroaktive, largimet bëhen nga Zyra e Personelit për Sistem të Pagave si dhe (kërkesa të ndryshme individuale të stafit: pushime, vërtetime etj).
- Përcaktimi i statusit të zyrtari publik sipas Rregullores Nr.10/2020 të zyrtarëve të Administratës Komunale, Arsimit dhe Shëndetësisë.
- Shkarkimi i listës së pagave nga sistemi i pagave dhe shpërndarja e tyre në Administratën Komunale, Arsimit dhe Shëndetësisë.

-Për më shumë, në formë statistikore, gjeni të bashkangjitur një tabelë, pjesë e këtij raporti përmbledhës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Raport mujor i punës Janar ,Shkurt ,Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor Nëntor, Dhjetor.	12
2	Kërkesë për autorizim në DASHC/MAP	22
3	Vendime për emërim të drejtorëve dhe stafit mbështetës	5
4	Pushim Përdëllimi	1
5	Pushime mjekësore	59
6	Pushime vjetore.	85
7	Pushimi pa pagës –vendim	2
8	Punimi i listës për pagesë për sistem të pagave për anëtarët e kuvendit	461
9	Punimi i listave për ardhje-shkuarje për Kulturë, Rini dhe Sport	36

10	Punimi i Listave për Ndryshime	38
11	Punimi i Listave për Punonjës të rinj	6
12	Punimi i Listave për Punëtorët e Larguar	14
13	Njoftimi i zyrtareve te lart publik për deklarim ne Antikorrupsioni me kopje fizike dhe emaila zyrtar	55
14	Njoftim për katalogun e dhuratave ne Antikorrupsioni	1
15	Tabela Informuese për Antikorrupsioni	1
16	Pushimi i Lehonisë – vendim	3
17	Vendim për Kodin e Etikës	1
18	Vendim për lejimin e kryerjes së praktikës	15
19	Vendim për Formimin e Komisionit Rekrutues	3
20	Kërkesë për DASHC-MAP për ndryshimin e gradave ne sistem	1
21	Shpallje të Konkurseve Publike	2
22	Njoftimi për vlerësimin e rezultateve ne punë për vitin 2020	31
23	Punimi i Kodit te Etikes	1
24	Vërtetim për përvojë të punës	13
25	Printimi, shpërndarja dhe mbledhja e listave të pagave	220
26	Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit	5
27	Vendime për Udhëtime Zyrtare	2
28	Vërtetim për Përfundimin e Praktikes	6
29	Kërkesë për emërim të kandidatit	1
30	Formulari përmbledhës për Vlerësimet e Rezultateve në Punë	1
31	Njoftim për secilin drejtorët për vijueshmërinë në punë të punëtorëve ardhje dhe shkuarje	117
32	Shkresa Përcjellëse për KPMSHCK	1
33	Vendim për autorizimi për ushtrimin e detyrës zyrtare	4
34	Vendim Ushtrues Detyre	7
35	Vendim për zëvendësimin e komisionit disiplinor	2
36	Përgjigje në kërkesa te ndryshme	12
37	Njoftim për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës se pensionimit	7
38	Kompletimi i Lëndëve për Auditor të Jashtëm	/
39	Njoftimi për Kodin e Etikës	13
40	Ftesa- për komision disiplinor	2
41	Punimi i Konkurseve	4
42	Vërejtje me shkrim për Nëpunësit Civil	2
43	Punimi i formularit për Retroaktiv	18
44	Punimi i formularit për Transfer Bankar	13
45	Vendim për Punë Shtesë	1
46	Aktemrime	7
47	Punim i Planit te Personelit për Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi dhe SIMBNJ	6
48	Punimi listave për caktimin e statusit zyrtarit Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi	3
49	Vendim për Emërim	2
50	Kompletimi i dosjeve me te dhënat personale sipas ligjit te ri	16
51	Plani i trajnimeve për 2020	1
52	Planifikimi i buxhetit ne paga për vitin 2021-2023	1
53	Një Pëlqim për Praktikë	1
54	Njoftim për pushim dita e çlirimit të Komunës 12 Qershori	1
55	Vendim për kompozim te pushimit 1 or në ditë	1

56	Vendim për pushim të përdëllimit	1
57	Kërkesë për aprovim të ndryshimit të koeficienteve	1
58	Kërkesë për pagesë retroaktive	6
59	Njoftim për në Komision Disiplinor	1
60	Përditësimi i të dhënave në SIMBNJ	48
61	Regjistrimi aplikacioneve e kandidateve në SIMBNJ për Zyrtarë të Lartë Ligjor dhe Zyrtar të Gjendjes Civile	32
62	Njoftimi i kandidateve për test me shkrim dhe intervistë për Zyrtarë të Lartë Ligjor	10
63	Njoftimi i kandidateve për emërimin e kandidatit Zyrtarë të Lartë Ligjor	3
64	Njoftimi i kandidateve për test me shkrim për Zyrtar të Gjendjes Civile	27
65	Njoftimi i kandidateve për mos kalim të testit me shkrim për Zyrtar të Gjendjes Civile	16
66	Njoftimi i kandidateve për intervistë për Zyrtar të Gjendjes Civile	5
67	Shkresa të ndryshme zyrtare përmes ime llave zyrtare	121
68	Ndryshime të aktit të emërimit	1
69	Vendim për pushim të përdëllimit	1
70	Pëlqim për Transferim	2
71	Kërkesë në SIMBNJ për drejtorët e drejtoratëve	10
72	Kërkesë për aprovim të Konkurseve për Ministrin e Punëve të Brendshme	10
73	Publikimi i konkurseve për Drejtoratin për Arsim	4
74	Vendim për pagë shtesë	1
75	Njoftim për periudhën provuese	5
76	Vendim për transferim të përkohshëm në vendin tjetër të punës	3
77	Autorizim	1
78	Vendim për Pushim Martesor	1
79	Kërkesa për kthim të parasë publike për tre drejtorat	3
80	Shkresa dërgimi i lëndës në komision disiplinor	8
81	Kërkesa për Konfirmim për disponueshmëri të mjaftueshme të mjeteve financiare	2
82	Kërkesa për Konfirmim për sistem të pagave për pagesë të zyrtarëve që janë ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut nga covid-19	50
83	Punimi i regji strateve për shtesën 300 me rastin e pandemisë COVID	3
84	Vendim për paga shtesë	2
85	Kërkesa të ndryshme	5
86	Kompletimi i lëndëve për Avokaten Komunale	45
87	Njoftim për festat zyrtare	1
88	Punimi i listave për vijueshmëri për praktikantët me pagesë	26
89	Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës me dorëheqje	1
90	Kompletimi i dosjeve me të dhëna personale sipas Ligjit të ri	16
91	Gjithsejt:	1817

SEKTORI PRONËSORO – JURIDIK

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

-Gjatë periodës raportuese është bërë përcjellja e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës.

-Gjatë tërë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

-Gjatë periodës raportuese të vitit 2020 me kërkesë të Kryetarit janë përgatitur Vendime, Shkresa të ndryshme Pëlqime, Kontrata dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

STATISTIKAT

1.Aktet e përgatitura nga Sektori Pronësoro-Juridik për vitin 2020:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendime	3
2.	Shkresa	200
3.	Pëlqime	6
4.	Kontrata	3
5.	Propozim-Vendime	8

Sektori Pronësoro-Juridik ka pranuar lëndë nga Drejtorati i Administratës Komunale, Sektor të komunës si dhe lëndë të parashtruar nga palët, në procedurë administrative kemi pranuar gjithsej 226 lëndë, prej tyre të kryera 220 dhe në procedurë janë 6 lëndë.

TAKIME E NDRYSHME

-Sektori Pronësoro-Juridik ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

SFIDAT

-Gjatë kësaj periudhe kemi pasur sfida, kryesisht në udhëzimin e palëve për kompletimin e dokumentacionit gjatë parashtrimit të kërkesave të tyre si dhe në sjelljen e dokumentacionit për kompensim nga ana e pronarëve bazuar në legjislacionin në fuqi të cilëve i është prekur prona e paluajtshme për shpronësim lidhur me ndërtimin e rrugëve.

ZYRA LOKALE PËR KOMUNITETE

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- vizitat e familjeve të riatdhesuara,
- marëveshje me IOM për projektet individuale dhe projektet për komunitete,
- mbajtja e komisionit komunal për të riatdhesuarit
- mbledhja e projekteve për personat e riatdhesuar për vetpunësim,
- aplikimet për projektet e infrastrukturës për komunitete,
- takim me FDMC në lidhje me përdorimin e gjuhës në komunë,
- shpërndarja e ndihmave familjeve skamnore,
- regjistrimi i familjeve të kthyer
- takim me përfaqësuesin e Avokatit të Popullit, Caritas, MZP,
- përmirësim i koordnimit dhe bashkpunimit në lidhje me zgjidhje të përhershme për të kthyerit dhe personat e zhvendosur brenda vendit,
- Zgjidhja e problemeve me familjet e riatdhesuara (akomodim, ankesa, vendime)
- ndihma nga Caritasi për fillimin e biznesit privat
- trajnime online nga OSBE.

-Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 9 familje të kthyer me 14 anëtar të familjes, janë mbajtur 6 komisione komunale për riintegrimin e personave të riatdhesuar, janë shqyrtuar 7 kërkesa për akomodim dhe janë miratuar të gjitha kërkesat, janë lëshuar 23 konfirmime personave të riatdhesuar, kemi marrë pjesë në punën e komisionit qëndrorë për të kthyerit, nga gjithsej 14 kërkesave për kthim janë zgjedhur 7 kërkesa, 4 kërkesa janë refuzuar ndërsa 3 janë në procedurë. Janë pranuar 20 kërkesa nga komunitetet të cilat kanë nevojë për ndihmë nga komuna.

-Gjatë kësaj periudhe në bashkpunim me OJQ-në Nëna Terezë kemi ndarë 300 kg miell në 5 familje skamnore, me organizatën joqeveritare IOM kemi vizituar 1 aplikant i cili ka aplikuar për ndarjen e subvencioneve për fillimin dhe zgjerimin e biznesit privat, kemi punuar në hartimin e listës për nevojat e ndërtimit dhe renovimit të shtëpive për familjet skamnore nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, jemi angazhuar rreth kade të rinj nga komunitetet, kemi punuar në mbledhjen dhe dorëzimin e të dhënave në ministrinë kompetente dhe komunë për kompletimin e kërkesave të klientëve, jemi angazhuar në gjetjen e apartamenteve për të strehuar familjet e riatdhesuara, 14 familjeve skamnore ju kemi ndarë një ndihmë financiare, Caritasi përmes programit të tij SUREP ka zgjedhur 8 projekte për vetpunësim, Ministrisë për komunitete i është dorëzuar një regjistër i kërkesave të të kthyerve që janë zgjedhur por nuk i kanë ushtruar të drejtat e tyre nga periudha 2010-2020, në MPB është dorëzuar lista e fëmijëve të riatdhesuar për ofrimin e ndihmës së pakove ushqimore, në MPB është dorëzuar lista e familjeve të kthyer, (3) për ofrimin e ndihmës ushqimore nga CARITAS, ZKKK-ja ka punuar në hartimin e listës së familjeve skamnore të komunitetit ashkali me ndihmën ushqimore, mjetet shkollorë janë dërguar në shkollën fillore të mesme të ulët në Medvec. Në bashkpunim me koordinatoren e MPB-it dhe zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale rregullisht kemi vizituar familjet e riatdhesuara, rregullisht është azhuruar data baza.

DREJTORATET KOMUNALE

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

-Në Drejtorinë e Administratës për vitin 2020, duke i respektuar rekomandimet e institucioneve përkatëse lidhur masat kundër covid-19, që nga muaji marsit e tutje me pandemi kemi vazhduar me punën e shërbimeve me qytetarë në Qendrën për shërbime me qytetarë në komunë, si dhe në sektorë të tjerë. Gjatë këtij viti janë arritur rezultate të kënaqshme si në aftësi dhe cilësi të menaxhimit të punëve në përmbushjen e objektivave /detyrave kryesore nga plani i punës përmes realizimit të gjitha aktiviteteve dhe vlera të suksesshme në kordinimin e funksionimit të shërbimit komunal ndaj qytetarëve. Nëpërmjet komunikimit korrekt dhe transparent, me një performacë që tejkalon shumë pritjet, në mbështetje të parimeve: parimi ligjshmërisë, parimi i administratës së hapur, parimi i proporcionalitetit, parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, parimi i objektivitetit dhe paanësisë, parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

-Pranimi dhe protokollimi i të gjitha kërkesave apo ankesave të qytetarëve dhe personave juridik si dhe aktet tjera të pranuar dhe të ndara protokollohen në evidencën themelore, me numër unik të protokollit nëpërmes programit të intranetit. Të gjitha shkresat që adresohen në mënyrë elektronik apo fizik në komunë protokollohen me një sistem të protokollit sipas ligjit në fuqi nr. 04/L-184 për administrimin e punës në zyrë.

Me koordinimin e punëve dhe në bashkëpunim me menaxherët tjerë në Komunë është arritur përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve në QSHQ.

-Nga programi i intranetit të librit të protokollit të gjitha kërkesat apo ankesat e qytetarëve dhe personave juridik janë të ruajtura në dy mënyra në elektronike dhe kopje fizike si dhe është bërë shtypja e librit të protokollit për kërkesat nga sistemi i intranetit.

-Janë protokolluar një numër i madh i kërkesave nga inspektorati sanitar për kundërvajtje për shqiptime të dënimeve mos respektimin e masave për covid –19 për në gjykatë, si dhe vendime dhe shfuqizime për qytetarë që kanë rezultuar pozitiv.

-Përmes avancimit të programit në sistemin e menaxhimit dhe arkivimi elektronik të dokumenteve, bëhet arkivimi dhe selektimi i lëndëve në sistem, ruajtja në formë fizike e materialit arkivor bëhet përmes serverit përkatës, çdo lëndë që protokollohet përmes intranetit dhe ruhen në këtë sistem. Ruajtjen afatgjatë të shënimeve elektronike bëhet në bashkëpunim me zyrtar të TI-së

-E-kioska e cila shërben për shërbimet e gjendjes civile në mënyrë elektronike ka funksionuar për një kohë të cilën qytetarët janë pajisur, gjithashtu sistemi i radhës me numër ka funksionuar duke respektuar kohën e pritjes dhe marrjes së shërbimit nga qytetari.

Në sektorin e Gjendjes civile kemi pasur numër të lartë të kërkesave nga qytetarët për tu pajisur me certifikata dhe me një angazhim të stafit janë lëshuar në kohë të shpejt pa pasur pritje të gjata të qytetarëve.

-Kemi menaxhuar dhe mbikëqyr kontrata të cilat janë të lidhura dhe kryejnë shërbime në drejtorin e administratës.

-Kemi realizuar projektin e sistemit të menaxhimit të radhës në qendrën për shërbime me qytetarë ku ka lehtësuar shërbimet për qytetarë.

-Kemi pasur fokus menaxhimin e shfrytëzimit në mënyrë të drejt dhe korrekte të veturave zyrtare nga ana e zyrtarëve komunal si dhe për menaxhimin e pandemisë me covid-19.

-Kemi bërë harmonizimet e rregulloreve komunale me udhëzimet administrative dhe ligjet në fuqi.

Kemi pasur përkushtim të vazhdueshëm në fushat ku jemi vlerësuar nga niveli qendror dhe ne si komunë kemi treguar një performancë të mirë gjatë vlerësimit.

Menaxhimi i veturave zyrtare dhe mirëmbajtja e objektit të komunës ka qenë në nivel të duhur, duke i ndihmuar me katër vetura zyrtare policisë, duke pasur parasysh gjendjen me pandemi të cilat jemi përball me masat e shtuara në varësi.

-Si dhe njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, aktivitetet të kanë qene të parapara me programin vjetor te punës për vitin 2020 janë përgjysmuar, për shkakë të zhvillime me pandemi covid- 19.

STATISTIKAT

SEKTORI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
	Protokollimi i kërkesave, ankesave si dhe aktet tjera te personave fizik dhe juridik, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë	
1	Kërkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	14875
2	Kërkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	557
3	Kërkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	29329
	Pranimi dhe Dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postes së institucionit.	
4	Aktvendime të Shpërndara	386
5	Ftesa të Shpërndara	1888
6	Vendime të Shpërndara	207
7	Fletëparaqitje për Gjykatë	2026
8	Njoftime të Shpërndara	307
9	Të Arritura me Postë	376
10	Të Dërguara me Postë	1416
11	Fatura tatimore të Qirasë	68
12	E veçantë për të raportuar harxhimet në të holla për dorëzim në postë janë; 2824,80€	
	Zyrtari i Pranimi/Logjistikës	
13	Futja e të dhënave në SIMFK – Frebalanc	2661
14	Komentet në raportin e pranimi të mallit me modul të blerjes.	2661
15	Pranimin e mallit të cilën është porositur malli nga furnitorët ekonomik.	464
16	Përgatitja e formularëve të shënimeve për mallrat e pranuar me anë të kërkesës interne nga organet përkatëse të cilët kanë kërkuar furnizim të mallit.	464
17	Përgatitja e formularëve për mallin e pranuar me anë të fletë dërgesës nga operatorët ekonomik.	464
18	Regjistrimi i faturave në librin hyrës dhe dalje.	664
19	Shpërndarja e mallit të pranuar nga operatorët ekonomik.	371
20	Stoqe të grumbulluar me material në depon e komunës	73

SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Ekstrakt i lindjes	21436
2	Certifikatë e martesës	3705
3	Certifikatë vdekje	1378
4	Certifikatë Vendbanimi	1011
5	Certifikatë Shtetsie	406

6	Certifikatë e Statusit martesor	1218
7	Certifikatë të lindjes	8596
8	Certifikatë e BF	3867
9	Aktvendime nga lëmia e gjendjes Civile dhe Akt Vdekje	288

SEKTORI PER PUNË TE KUVENDIT DHE KOMITETEVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Mbajtja e procesverbalit nga mbledhjet e KK	13	183 faqe
2.	Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e KK	13	145 faqe
3.	Nxjerrja e Vendimeve dhe akteve të tjera nga mbledhjet e Kuvendit	36	111 faqe
4.	Përkthimi i Ekstrakteve	32	132 faqe
5.	Përkthime zyrtare-simultane në organe të ndryshme	98	186 orë
6.	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorateve	99	263 faqe
7.	Përkthimi i shkresave të tjera	111	219 faqe
8.	Fotokopjimi	480	46611 faqe
9.	Mbajtja e Procesverbalit nga mbledhjet e KPF-së	7	57 faqe
10.	Nxjerrja e Ekstrakteve nga mbledhjet e KPF-së	7	40 faqe
11.	Mbajtja e procesverbalit dhe Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e komiteteve tjera dhe komisioneve të ndryshme	11	72 faqe
12.	Mbajtja e procesverbalit dhe nxjerrja e ekstraktit nga mbledhja e KKS	6	66 faqe
13.	Përgaditja e ftesave të ndryshme për mbledhje dhe tubime të ndryshme.	57	795 faqe
14.	Përgaditja e rexhistrave të ndryshëm (për meditet e anëtarve të Kuvendit dhe komiteteve e të ngjajshme)	71	133 faqe
15.	Të ndryshme(dërgimi i dokumenteve për veb faqe,dokumente të skenuara në MAPL etj. të ngjajshme)	176	1141 faqe
16	Rregullore,Plan, Korniza e të ngjajëshme-	7	150 faqe
17	Lektorim të materialeve të ndryshme (rregullore, vendime ekstrakte,raporte,ftesa etj. të ngjajëshme)	194	690 faqe
19.	Gjithsejt	1418	50994 faqe
			Përveq kësaj që pasqyrohet me faqe janë edhe 186 orë përkthim gojor

SEKTORI PËR MIRËMBAJTJE DHE OPERIM

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1.	Furnizimi me lëndë djegëse- karburant për gjeneratorë dhe mesatarja e shpenzimeve.	/	210 litra karburante
2.	Furnizimi me lëndë djegëse-/naftë/ karburant për ngrohje qendrore	1	12200 litra karburante
3.	Furnizim me karburante- automjete	19	16611 lit. Karburante
4.	Evidentimi i kilometrave të kaluar të automjeteve dhe mesatarja e shpenzimeve	19	189948 kilometra

5.	Mirëmbajtja e higjienës në sipërfaqe	//	3200 m
6.	Servisimi i automjeteve	29	
7.	Bartja e zyrtarëve komunal në trajnime- Prishtinë	433	
8.	Vazhdim i regjistrimit të automjeteve	14	
9.	Kërkesa për veturë zyrtare	1975	

NJËSITI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1.	Trajnime	10	//
2.	Takime	26	//
3.	Debate	4	//
4.	Tryeza të rrumbullakëta	2	//
5.	Komente dhe sugjerime	49	//

TAKIME TJERA

- Sa i për ketë takimeve për vitin 2020, janë reduktuar për arsye të masave të rekomanduara nga IKSHIP për covid -19
- Takime në komitetin e auditimit në komunë;
- Takime dhe punëtori me bankën botërore - INFC, për thjeshtëzimin e procedurave administrative për komunën;
- Komisione për inventarizimin e pasuruese jo financiare të komunës;
- Komisione për përzgjedhës i shërbimit civil të komunës;
- Takime të grupit për performancën komunale në MAPL- DEMOS në përmes platformës zoom;
- Trajnime për zyrtarët për barazi gjinore;

SFIDAT

-Për shkak të gjendjes me pandemi dhe duke i respektuar masat kundër covid-19, ku kërkohet edhe shërbimet me të shpejta dhe efikase. Njëra nga pengesat të cilat e ngadalëson punën në shërbime me qytetarë është sistemi elektronike intraneti i ngadalshëm.

DREJTORATI PËR ARSIM

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria e Arsimit, në vazhden e punëve dhe detyrave, të parapara, në funksion të ngritjes së cilësisë dhe në funksion të realizimit të punëve dhe detyrave në përgjithësi, zhvillimit dhe përmirësimet në të gjitha segmentet e proceseve arsimore në shkollat e Komunës së Lipjanit, ka realizuar punët dhe detyrat sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë për këtë periudhë kohore, por njëkohësisht edhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura.

Për dallim nga vitet tjera viti 2020 ka qenë një sfidë dhe përvojë e re si për personelin arsimor nxënësit ashtu edhe për prindërit për arsye të paraqitjes së pandemisë Covid 19.

Që në fillim të muajit pas paraqitjes të rasteve të para të Covid 19, MASH-i në bashkëpunim me akterët e tjerë, përfshirë drejtoritë e arsimit në nivel Komunal, dhe organizatat joqeveritare, filloi planifikimet për mësimin online për fëmijët e grup-moshave të caktuara dhe për lëndë të veçanta (gjuhë dhe matematikë). Mësimi në distancë filloi me prezantimin e orëve mësimore përmes video-incizimeve të transmetuara në

televizionin nacional (RTK) përmes të cilave prezantoheshin mësim nga mësimdhënës të përzgjedhur për lëndën e gjuhës shqipe dhe matematikës, për nxënësit e klasave 1-5.

Më tutje, në kuadër të planifikimeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për planifikimin e mëtutjeshëm të mëimit në distancë publikohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mëimit përmes të cilave specifikohet roli i secilës palë të angazhuar në institucionet edukativo-arsimore parauniversitare në vend (MASH, 2020).

Mbyllja e institucioneve edukativo-arsimore për shkak të masave parandaluese ndaj përhapjes së Covid-19 ka ndikuar në arsimimin, mirëqenien dhe mënyrën e funksionimit të gjitha palëve të involvuara dhe përfituese nga sistemet arsimore. Derisa procesi i zhvendosjes së mëimit në formatin në distancë ose online është bërë tanimë pjesë e institucioneve edukative arsimore dhe një sërë faktorësh të ndërlikur me cilësinë e institucioneve edukativo-arsimore, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit, në ndërveprim me ndryshimet në gjendjen e tyre emocionale të shkaktuar nga ndryshimi i formatit të mëimit, dhe izolimi në shtëpi, supozohet të jenë faktorë kontribues të cilët mund të ndikojnë në kualitetin e realizimit të mëimit në distancë ose online, përformancën e mësimdhënësve dhe njohuritë e shkathtësitë e nxënësve. Rrethanat e reja të krijuara kundër përhapjes së Covid-19, përfshirë ndryshimet në arsim, kanë shkaktuar një sërë shqetësimesh tek nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit brengat e përbashkëta në raport me vlerësimin e nxënësve, shqetësimet dhe mbingarkesën, si dhe vlerësimet për mos përshtatshmërinë e mëimit të realizuar deri më tani. Mirëpo që në fillim kemi vërejtur gatishmërinë dhe motivimin e mësimdhënësve për të avancuar njohuritë dhe shkathtësitë e tyre dhe për të kontribuar me synim avancimin e cilësisë së arsimit.

AKTIVITETET

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i kuadrit arsimor të kualifikuar për institucionet edukativo arsimore;
- Sistemimi i mësimdhënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, si rezultat i ndryshimeve kurrikulare;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale;
- Organizimi i mëimit në distancë
- Furnizimi i shkollave me materjal higjenik (dezinfektues dhe maska)
- Formimi i task forces për organizimin e mëimit për shkak të pandemisë covid 19
- Përgaditjet për vlerësimin e mbrendshëm dhe të jashtëm (testit të arritshmëris dhe testit të maturës;
- Përpunimi i statistikave të pranuar nga shkollat
- Planifikimi i regjistrimit të nxënësve (klasa e pare dhe klasa e dhjetë)
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Identifikimii nevojave të mësimdhënësve për trajnime;
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Hartimi i rregullores për dhënen e bursave
- Takimet të rregullta me drejtor;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Furnizimet e shkollave me materjal shpenzues, inventar shkolllor, mjete didaktike, rekuizita sportive, paisje të teknologjisë informative furnizimi i bibliotekave shkollore me libra.
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Bashkpunimi dhe nënshkrimi i marveshjeve dhe memorandumeve të mirkuptimit me OJQ dhe organizata qeveritare.

- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përcjellja dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me material didaktik dhe higjienike;
- Furnizimi çerdhës së re me inventar mjete të kuzhinës si dhe materjal tjetër të domosdoshëm;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me tekste shkollore për nxënësit

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Organizimi i sistemit arsimor parauniversitar në Komunën e Lipjanit,

Sistemi arsimor në Komunën e Lipjanit organizohet në nivelet **0, 1, 2 dhe 3**, me gjithsejtë **28** Institucione Arsimore – shkolla amë dhe 30 paralele të ndara, prej të cilave **2** Institucion për edukimin parashkollor, **25** SHFMU me **27** p.n.f dhe **3** SHML me **2** p.n.f. Tri SHML janë të organizuara në këtë mënyrë: Një shkollë Gjimnaz, një shkollë Profesionale dhe një shkollë Mikse.

Sa i përket trajnimeve, mësimdhënësit e Komunës sonë edhe gjatë vitit shkollor 2019/2020 kanë vazhduar me trajnime të ndryshme. Mësimdhënësit të cilët kanë filluar me zbatimin e kurrikulës nga viti shkollor 2019/2020, për parafillor, klasa e parë, klasa e gjashtë dhe klasa e dhjetë kanë përfunduar trajnimet për të gjitha fushat kurrikulare dhe pastaj nga trajneri i fushës dhe koordinatori i kurrikulës në nivel Komune ju është bërë vlerësimi i dosjeve të tyre.

MASH-i edhe gjatë vitit 2020 ka paraparë trajnimet për zbatimin e kurrikulës për mësimdhënësit të cilët nga muaji shtator i vitit shkollor 2020/2021 kanë filluar mësimin me parafillorët, klasën e parë, klasa e gjashtë dhe klasën e dhjetë për fushat: Parafillorët, Klasa e parë, Gjuhët dhe komunikim, Matematikë, Shkencat Natyrore, Shkencat Shoqërore, Tik, Artet dhe Edukim Fizik.

Përveq trajnimeve të organizuara rreth zbatimit të kurrikulës, mësimdhënësit kanë ndjekur dhe vazhdojnë të ndjekin edhe trajnime të tjera në mënyrë që të jenë në hap me metodologjitë e reja të cilat përvetësohen përmes trajnimeve të ndryshme.

Nga projekti i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë për përmirësimin e ngritjes së kapaciteteve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve (trajnime të mësimdhënësve parashkollor dhe fillor) nga Komuna e Lipjanit janë trajnuar mësimdhënësit e 3 shkollave fillore: Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan, Shfmu “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan dhe Shfmu “Shjefën Gjeçovi” në Janjevë. Gjithashtu në kuadër të projektit në fjalë janë çertifikuar edhe 6 mësimdhënës si mentor të shkollave të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në shkollat e tyre.

Organizimi i procesit arsimor në online - distancë në kushte të pandemisë

Pas ndërprerjes së mësimin në institucionet arsimore për arsye të pandemisë dhe duke mos pasur një parashikim se sa mundë të jetë kohëzgjatja e kësaj pandemie, u paraqit nevoja që të gjendeshin forma alternative me qëllim që nxënësit mos të humbnin në mësimnxënie. DKA duke qenë në komunikim të vazhdueshëm me MASH-in dhe drejtorët e shkollave filluan zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve për të filluar mësimin në distancë në fillim përmes video incizimeve nga televizioni nacional RTK e më vonë edhe përmes formave tjera siç ishin ZOOM dhe rrjete tjera sociale.

Edhe pse në fillim kishte vështërsi në zbatimin e kësaj forme të mësimin për arsye të ndryshme qofshin ato të mungesës së pajisjeve teknologjike apo përvoja e pamjaftueshme e përdorimit të sistemit online,

personeli arsimor, nxënësit dhe prindërit shpejt u adaptuan me këtë mënyrë të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Mbajtja e mësimi online- distancë e paraqitur në mënyrë tabelore:

Pjesëmarrja e nxënësve, mësimdhënësve dhe orët e mbajtura

Tabela 2: muaji prill

muaji/viti	Kategorizimi sipas niveleve	Forma e aplikimit				Realizimi					Lëndet mësimore.	Sfidat - vështërsit
		vide o	zoom	chat	facebook	Nr. total i nx. që shkollë	Nr. i nx. që angazh. uar.	Nr. i nx. që kanë munguar.	Nr. i mësimeve të bëra	Nr. i orëve të mbajtura.		
prill/2020	0-5 vj.	V	V	V	V	822	768	54	46	1905	Janë mbajtur pothuajse të gjitha lëndët	Më e theksuar mungesa e mjeteve teknologjike. Mos angazhimi i të gjithë mësimdhënësve dhe nxënësve
	1-5	V	V	V	V	4787	4434	353	306	18484		
	6-9	V	V	V	V	3896	3337	559	403	18046		
	10-12	V	V	V	V	2660	2575	85	179	9278		

Tabela 3: muaji maj

muaji/viti	Kategorizimi sipas niveleve	Forma e aplikimit				Realizimi					Lëndet mësimore.	Sfidat - vështërsit
		vide o	zoom	chat	facebook	Nr. total i nx. që shkollë	Nr. i nx. që angazh. uar.	Nr. i nx. që kanë munguar.	Nr. i mësimeve të bëra	Nr. i orëve të mbajtura.		
maj /2020	0-5 vj.	V	V	V	V	964	904	60	59	2286	Janë mbajtur pothuajse të gjitha lëndët	Më e theksuar mungesa e mjeteve teknologjike. Mos angazhimi i të gjithë mësimdhënësve dhe nxënësve
	1-5	V	V	V	V	4787	4561	184	297	19209		
	6-9	V	V	V	V	3896	3397	499	410	19527		
	10-12	V	V	V	V	2660	2596	64	179	11041		

Tabela 4: muai Qershor

muaji/viti	Kategorizimi sipas niveleve	Forma e aplikimit				Realizimi					Lëndet mësimore.	Sfidat - vështërsit
		vide o	zoom	chat	facebook	Nr. total i nx. që shkollë	Nr. i nx. që angazh. uar.	Nr. i nx. që kanë munguar.	Nr. i mësimeve të bëra	Nr. i orëve të mbajtura.		
qershor/2020	0-5 vj.	V	V	V	V	964	893	70	58	2427	Janë mbajtur pothuajse të gjitha lëndët	Më e theksuar mungesa e mjeteve teknologjike. Mos angazhimi i të gjithë mësimdhënësve dhe nxënësve
	1-5	V	V	V	V	4747	4517	270	280	19763		
	6-9	V	V	V	V	3896	3340	556	428	18977		
	10-12	V	V	V	V	2660	2190	470	156	4013		

Sfidat në zbatimin mësimi online – distancë

Mungesa e pajisjeve teknologjike në të gjitha shkollat (telefon, kompjuter, laptop, rrjet etj), kryesisht në vendet rurale dhe vijimi jo i rregullt i një pjese të nxënësve tek disa lëndë mësimore. Përgatitja jo e duhur e një pjese të mësimdhënësve për përdorimin e pajisjeve teknologjike respektivisht mosnjohja e funksionimit të aplikacioneve dhe platformave të mësimi. Në disa shkolla ku ka nxënës të komunitetit

ashkali përveç mungesës së mjeteve teknologjike problem tjetër është se një numër i madh i familjeve të nxënësve nga komuniteti janë në kushte të vështira ekonomike e shumë probleme tjera që i'u pamundëson mbajtjen e mësimit në distancë apo për të komunikuar me mësime të mësimdhënësit. Shkollat e mesme në bazë të udhëzimeve të MASH-it kanë plotësuar dëftesat dhe diplomat e nxënësve për të gjithë ata të cilët kanë përfunduar klasën e XII-dymbëdhjetë.

Përfundimi i vitit shkollor 2019/2020

Me datën 20.05.2020 ka përfunduar viti shkollor për nxënësit maturant, me datën 12.06.2020 ka përfunduar viti shkollor për nxënësit semimaturant (klasa e IX- nëntë) dhe për nxënësit e shkollave të mesme (10 dhe 11) dhe me 26.06.2020 për nxënësit fillor (1-9).

STATISTIKAT

Rezultatet rreth suksesit të nxënësve për gjysëm vjetorin e dytë për vitin shkollor 2019/2020 janë paraqitur në formë tabelare:

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2019/2020

Arsimi fillor (1-5)

Komuna :LIPJAN

Klasa	Nr. paraleleve	Nr I nxënësve	Suksesi pozitiv										Gjithsej me nota negative që përcillen		Të pa notuar		Numri i mungesave			Nota mesatare
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive						Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej	
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%				
1	61	949	643	67.75	157	16.54	94	9.99	92	4.85	940	99.05			9	0.95	4099	504	4603	3.98
2	60	991	596	60.15	181	18.27	139	14.02	69	6.98	985	99.4			6	0.6	5122	1018	6140	4.04
3	62	1007	631	62.67	188	18.67	126	12.52	62	6.16	1007	100					5857	1779	7636	4.07
4	61	923	528	57.2	182	19.71	145	15.73	51	5.52	906	98.16	14	1.51	3	0.32	5137	1734	6871	4.03
5	51	913	521	57.06	176	19.27	139	15.22	72	7.88	908	99.45	2	0.22	3	0.32	4564	1060	5624	3.99
GJ	295	4783	2919	61.03	884	18.49	643	13.45	300	6.28	4746	99.23	16	0.34	21	0.44	24779	6095	30874	4.03

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2019/2020

Arsimi i mesëm i ulët (6-9)

Komuna :LIPJAN

Klasa	Nr. paraleleve	Nr l nxënësve	Suksesi pozitiv										Suksesi i pamjaftueshëm								Të pa notuar		Numri i mungesave			Nota mesatare
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Përcillen në riprovim					Përsërisin klasën					Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej	
													Me 1 notë të pamjaftueshme	Me 2 notë të pamjaftueshme	Me 3 nota të pamjaftueshme	Përsërisin klasën										
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%				
6	48	960	354	36.88	241	25.11	229	23.86	125	13.02	949	98.86									11	1.15	5682	1555	7237	3.63
7	49	914	316	34.58	230	25.17	221	24.18	132	14.45	899	98.35									15	1.65	6486	2110	8596	3.51
8	47	976	291	29.82	268	27.46	254	26.03	157	16.09	970	99.39	1	0.11							5	0.52	7048	3184	10232	3.47
9	49	978	333	34.05	222	22.7	259	26.49	156	15.95	970	99.19									8	0.82	6874	3375	10249	3.54
GJ	193	3828	1294	33.81	961	25.11	963	25.16	570	14.89	3788	98.96	1	0.03							39	1.02	26090	10224	36314	3.54

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2019/2020

Arsimi i mesëm i lartë (10-12)

Komuna :LIPJAN

Klasa	Nr. paraleleve	Nr l nxënësve	Suksesi pozitiv										Suksesi i pamjaftueshëm						Të pa notuar		Numri i mungesave			Nota mesatare
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Përcillen në riprovim				Përsërisin klasën				Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej	
													Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme									
Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%							
10	35	939	160	17.04	224	23.86	347	36.96	181	19.28	912	97.13	3	0.32			1	0.11	23	2.45	13073	8837	21910	3.2
11	32	859	132	15.37	166	19.33	367	42.73	169	19.68	834	97.09							25	2.91	12175	9645	21820	3.29
12	31	862	150	17.41	195	22.63	294	34.11	203	23.54	842	97.71							20	2.32	12423	8807	21230	3.4
GJ	98	2660	442	16.61	585	21.99	1008	37.9	553	20.8	2588	97.3	3	0.14			1	0.03	68	2.55	37671	27289	64960	3.3

Organizimi dhe përgaditjet për mbajtjen e vlerësimeve të jashtme: Testi i arritshmërisë dhe Testi i maturës 2020

Drejtorati i Arsimit me kohë ka bërë të gjitha përgaditjet e duhura për mbajtjen e testit të arritshmërisë dhe testit të maturës 2020. Përgaditjet janë bërë si në aspektin teknikë - sigurimin e klasëve të mjaftueshme sipas udhizimeve të MASH-it dhe IKSHP-së mbi distancë sociale, dezinfektimi i të gjitha shkollave sigurimi i dorëzave, maskave dhe materialit dezinfektues. Është bërë planifikimi i paraleleve me numër të nxënësve, formimin e qendrave të testimit dhe numrin e administruesëve për mbikëqyrjen e procesit të testimit si për testin e arritshmërisë ashtu edhe testit të maturës.

Përkundër të gjitha këtyre përgaditjeve me vendim të MASH-it dhe për arsye të pandemisë Covid-19, testi i arritshmërisë nuk është mbajtur fare ndërsa mbajtja e testit të maturës është shtyer, dhe kjo ka bërë që afati i parë i organizimit të testit të maturës mbahet me datën 29.08.2020 kurse afati i dytë me datën 10.10.2020.

PËRGADITJET PËR FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR 2020/2021

Regjistrimi i nxënësve për vitin shkollor 2020/2021

DKA duke respektuar afatet e parapara me kohë ka bërë shpalljet e njoftimeve për regjistrimin e fëmijëve në institucionin parashkollor ÇEAP – Çerdhja, regjistrimin e nxënësve në klasën e parë dhe nxënësve në klasën e 10 dhe janë dërguar në MASH planifikimet e regjistrimit për tri shkollat e mesme.

Për Çerdhe dhe nxënësit e klasëve të para regjistrimet janë bërë sipas afatit, ndërsa për arsye të mos mbajtjes së testit të arritshmërisë regjistrimet e nxënësve për klasën e 10 janë bërë në bazë të suksesit të tyre.

Plotësimi i vendeve të lira me kuadrin arsimor

Në bazë të informatave të pranuar nga shkollat, DKA për mungesën e kuadrit arsimor në të tri nivelet me datën 28.07.2020 ka shpallur konkursin për plotësimin e 25 vendeve të lira në të gjitha shkollat dhe pas procesit të intervistimit janë plotësuar të gjitha pozitat e lira.

Përkrahja e studentëve me bursa komunale

Me qëllim të përkrahjes finaciare të studentëve të komunës sonë, DKA bazuar në rregulloren e aprovuar nga kuvendi komunal për ndarjen e bursave ka bërë ndarjen e 134 bursave për student në shumë prej 500€.

Aspekti infrastrukturor dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore:

Përmirësimi i infrastrukturës shkollore na e mundëson realizimin më të lehtë të procesit të reformave arsimore dhe cilësinë në arsim, për këtë arsye Komuna e Lipjanit dhe DKA është angazhuar duke i dhënë një prioritet të veçantë me numër të madh të projekteve për investime në objekte shkollore duke investuar direkt në infrastrukturën shkollore ndërtim, renovim apo zgjerim përmes bashkëfinancimeve me organizata të ndryshme apo përmes planifikimeve buxhetore.

Gjatë vitit 2020 është bërë inagurimi i objektit të ri shkollor në:

- SHFMU “ Haradin Bajrami” Magurë
- SHFMU “ Drita “ – Rubovc
- ÇEAP “Çerdhja “ Lipjan

Janë bërë investime direkte në përmirësimin e kushteve për zhillimin e mësimin duke furnizuar shkollat me inventar, mjete të teknologjisë informative, instrumente muzikore, rekuizita sportive, janë pajisur me libra bibliotekat 15 shkolla ku sasia totale e librave është 43288 libra me gjithësejt 517 tituj. Instalimi i internetit në 22 shkolla dhe në Çerdhe.

Shumë investime infrastrukturore janë në procedurë të realizimit:

- Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan,
- Ndërtimi i shkollës së mesme në Gadime
- Në proces ndërtimi i Çerdhës në fshatin Gadime.

▪ Shkollat përfituese në bankën botërore:

- SHFMU “ Emin Duraku” në Banullë,
- SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan,
- SHFMU “Ismail Luma” në Lipjan kanë shpall konkurs për të dy kategoritë ekonomike:

a). Mallra dhe shërbime - do të trajnohen personeli shkollor,

b). Investime kapitale kanë furnizimin e shkollave të tyre në pajisje të ndryshme.

- Rregullimi i infrastrukturës së jashtme (rrethojave poligoneve sportive dhe parkingjeve) në 17 shkolla
- **Sigurimi transportit për nxënës në relacionin vendbanim - shkollë dhe anasjelltas për këto relacione:**
 - SHFMU “Nezë Bujani” Bujan, paralelja e ndarë Bregu i Zi deri në shkollën Bujan dhe anasjelltas

- SHFMU “Kadri Beba” Ribar i Madh - paralelja e ndarë Zllakuqan deri në shkollën në Ribar dhe anasjelltas.

▪ **Në bashkëpunim me MASH-in është bërë instalimi i kamerave në:**

- SHFMU “Nezë Bujani” Bujan
- SHFMU “Haradin Bajrami” Magurë
- SHFMU “Hasan Zyko Kamberi” Sllavi
- SHFMU “Shtjefën Gjeçovi” Janjevë.

Nënshkrimi i marrëveshjeve me organizata qeveritare dhe jo qeveritare për ngritjen cilësisë, përfshirë nënshkrime të memorandumëve të bashkëpunimit:

▪ **Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës së Lipjanit dhe OJQ “Zëri i Ashkalive dhe Egjiptasëve”:**

- Në kuadër të përkrahjes së komuniteteve romë dhe ashkali të përcaktuar në Planin Lokal të Veprimit 2018-2022 nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit për menaxhimin e 5 qendrave mësimore:
Qendra Mësimore në SHFMU “Ismail Luma” në Lipjan,
Qendra Mësimore në SHFMU “Haradin Bajrami” në Magurë,
Qendra Mësimore në SHFMU “Fehmi Agani” në Medvec,
Qendra Mësimore në SHFMU “Zenel Hajdini” në Gadime dhe
Qendra Mësimore në SHFMU “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë.

Marrëveshje Bashkëfinancimi mes Komunës së Lipjanit dhe Caritasit Zwitserland me qëllim të realizimit të Projektit “Vendosja e Standardeve Para-shkollore të Cilësisë së Lartë duke përfunduar Arsimin, Shkencën dhe Ekonominë:

- Është bërë furnizimi i 7 klasave parafillore (me inventar, lodra dhe materiale të tjera të ndryshme) në Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan, Shfmu “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan, Shfmu “Skenderbeu” në Kraishtë, Shfmu “Ernest Koliqi” në Babush i Muhaxherëve dhe Shfmu “Ibrahim Krasniqi” në Smallushë.

-

▪ **Memorandum mirëkuptimi me OJQ – Instituti Kosovar për Logopedi:**

- Qëllimi i kësaj marrëveshje është sigurimi i mundësive për trajnim dhe edukim të nxënësve me vështërsi në të nxënë në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

▪ **Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës së Lipjanit dhe The Ideas Partnership:**

- Fillimi i projektit “Education for All” që financohet nga BE / EIDHR në Kosovë, organizat ndërkombtare. Ky projekt ka të bëjë me përkrahjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut me fokus në promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve.

▪ **Memorandum mirëkuptimi mes Komunës së Lipjanit dhe OJQ – Germin:**

- Që ka për qëllim zhvillimin e një moduli interaktiv për diskutime dhe leksione që synojnë fuqizimin e gjeneratave të reja.

▪ **Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe ESVET PRO- Lux-Development S.A në emër të Projektit KSV/801 “Mbështetja e Bashkimit Europian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet në AAP të financuar nga Bashkimi Evropian, e cila ka për qëllim të ofrojë mbështetje për**

Institucionet e AAP-së në nivel Komunal, veçanërisht në zhvillimin e kurrikulave (duke përfshirë Standardet e Profesionit –Sp).

- **Marrëveshje bashkëpunimi mes DKA-së dhe OJQ- së ED GUARD për zbatimin e projektit Essilor VSION For Life,** projekt ky që parasheh kontrollën e syve për nxënësit nga klasa I-parë deri IX-nëntë.
- **Marrëveshje bashkëfinancimi mes Komunës së Lipjanit dhe Organizatës World Visionin**
 - Rregullimi i toaleteve në Shfmu “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë dhe
 - Pajisja e 10 shkollave me kabinete të TIK-ut dhe paisjen e Shfmu “Ismail Luma “ me instrumente muzikore.
- **Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës dhe Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim - QSHHZH:**
 - Implementimin e programit për zhvillim në fëmijëri të hershme, arsim gjithëpërfshirës dhe mbrojtje të fëmijëve. Me këtë rast përfituese është SHFMU “Zenel Hajdini” – Gadime ku është mundësuar hapja e një paralele për parashkollor të moshës 0-6.
- **Aktivitete tjera:**
 - Shpërndarja e laptopëve dhe kompjuterëve për nxënësit që nuk kanë pasur mundësi të kyqen në mësimin online,
 - Lansimi i platformës nga MASHT-i për mësimin online në fëmijëri të hershme mosha 0-6,
 - Lansimi i platformës online me Psikologët e Komunës së Lipjanit,
 - Marrja e vendimit për lirimin nga pagesa e tarifave në institucionin për edukimin dhe arsimimin parashkollor publik dhe
 - Hartimi i Rregullores për ndarjen e Bursave për studentët e Komunës së Lipjanit.

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë).

- Mbajtja e takimeve online me MASh-in, përfaqësues të organizatave të ndryshme si dhe me drejtorët e shkollave, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin.

SFIDAT:

- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale,
- Sistemimi i mësimdhënësve, të cilët janë rrezikuar si pasojë e ndryshimeve të planit mësimor (fondit të orëve), në shkollat ku është duke u implementuar KKK dhe
- Sigurimi i mësuesëve mbështetës.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (pushime të lehonisë, pushime mjekësore, pushime pa pagesë) dhe kërkesa të tjera që kanë qenë të adresuara në drejtorinë tonë.

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Synimi i punës së Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport është që të arrihen suksese të mëtutjeshme dhe sa më të mëdha në funksion të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive dhe sektoreve përkatës konform kompetencave që ka ky drejtorat.

Në kuadër të kompetencave tona jemi duke punuar sipas planit të punës dhe arritjes së objektivave dhe qëllimeve të drejtoratit. Drejtorati ka arritur të përmbushë objektivat sipas planit të punës, por për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid – 19, disa aktivitete të planifikuara janë reduktuar e disa të tjera edhe janë anuluar në tërësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhës RAPORTUESE

- Është organizuar ceremonia e ndarjes së çelësave të 10-të shtëpive për familjet në nevojë, shtëpi këto të cilat u ndërtuan në bashkëpunim me Komunën dhe shoqatën “Jetimat e Ballkanit”
- Kemi organizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për shënimin e 12-të vjetorit të Pavarësisë së Kosovës: Seanca solemne, homazhe, Ekspozitë në Bibliotekën e Qytetit, dekorimi i qytetit me flamuj, organizimin e turneut tradicional në futboll “Kupa e Pavarësisë”, tryezë me të rinjtë lipjanas, program kulturor-artistik në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” nga shkollat e mesme dhe fillore në Lipjan si dhe organizimi i koncertit festiv.
- Është dorëzuar raporti i subvencionimit të klubeve sportive për vitin 2019
- Kemi dorëzuar raportin vjetor të Bibliotekës së Qytetit në Bibliotekën Kombëtare
- Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi me organizatën UNICEF-Kosova, mbi të drejtat e fëmijëve dhe hapjen e qendrës së inovacionit për të rinjtë lipjanas
- Është bërë përmbyllja e projektit të ReLoAD, ku janë prezentuar puna e organizatës për kohën e veprimit në Komunën e Lipjanit, që përfitues ishin Gratë dhe të Rinjtë e Komunës sonë.
- Organizimi i puntëtorisë 3 ditore “PODIUM”, e financuar nga UNICEF Kosovo dhe e realizuar në bashkëpunim me komunën e Lipjanit, gjegjësisht me nxënësit e klasëve të 10-ta të dy shkollave të mesme.
- Është organizuar mbledhje komemorative për vdekjen e qytetarit të nderit të Lipjanit të shpallur në vitin 2018, z.Gani Demir Retkoceri.
- Kemi pranuar një donacion prej 434 librash për bibliotekën e qytetit nga shtëpia botuese Dukagjini
- Kemi bërë homazhe me rastin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
- Është bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve të cilat janë nën menaxhim të DKRS-së
- Është nderuar veprimtaria e Heroit Ismet Asllani,
- Në arkivin komunal ka vazhduar puna në klasifikimin dhe ndarjen e materialeve arkivore,
- Kemi shënuar ditët e rëndësishme të Komunës së Lipjanit, atë të 12 qershorit, Dita e Çlirimit të Komunës së Lipjanit dhe 14 qershorin, Dita e Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit, ku kemi bërë homazhe pranë lapidarëve dhe varreve të të rënëve, martirëve dhe dëshmorëve të komunës së sonë.
- Në ditën e çlirimit kemi shpallur “Qytetar Nderi të Komunës së Lipjanit”, zotri Halil Kastratin

- Me përkrahje të Komunës dhe UNICEF – Kosova, Grupi i të rinjëve në Lipjan, përfitues të projektit PODIUM, kanë realizuar aktivitetin e tyre duke vendosur 13 pika ushqyese për qenët endacak në qytetin e Lipjanit.
- Po ashtu grupi përfitues nga punësoria PODIUM ka paraqitur në Bibliotekën e Qytetit, ekspozitën me mesazhin vetëdijësues për parandalimin e përdorimit të narkotikëve.
- Është bërë përrurimi i tabelave të shahut në dy parqet e qytetit të Lipjanit, projekt i realizuar në kuadër të projektit “ReLOad”
- Subvencionet për sport, rini dhe kulturë janë dyfishuar në vitin 2020 me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të klubeve dhe OJQ-ve rinore, pavarësisht vështirësive me pandeminë, këtë vit janë ndarë 135,000.00 euro subvencione.
- Kemi vazhduar regjistrimin e librave të bibliotekës,
- Është përruruar Salla e sporteve në fshatin Kraishtë,
- Është organizuar gara e vrapimit “Vrapimi i Krushqve”, që promovon sportin e atletikës, garë kjo e cila synojmë të bëhet tradicionale për qytetin e Lipjanit,
- Kemi pranuar një donacion nga Minisitia e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për bibliotekën e qytetit, 854 libra dhe 103 tituj të rinjë,
- Është ofruar mbështetje financiare për botimin e 3 librave të autorëve të ndryshëm nga qyteti i Lipjanit.
- Kemi stolisur sheshin e qytetit me flamuj kombëtar e shtetëror për nder të festës së flamurit dhe kemi bërë homazhe pran shtatores së Adem Jasharit dhe Ismet Asllanit,
- Kemi lansuar një koncert festiv për nder të ditës së flamurit në formë elektronike,
- Kemi realizuar muralin në hyrje të bibliotekës për nder të festivalit multikulturor,
- Kemi finalizuar projektin e fotografimit të pasurive kulturore, sportive e natyrore në qytetin e Lipjanit.

INVESTIMET KAPITALE

Me qëllim që të rinjëve të ju krijojnë kushte sa më të mira për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, Komuna e Lipjanit në vitin 2020 përkundër situatës së krijuar me pandeminë ka vazhduar realizimin e projekteve kapitale në krijimin e hapësirave rekreative – sportive në territorin e komunës:

- Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Kraishtë
- Ndërtimi i fushave të hapura sportive në : Teqe, Kojskë, Gllanicë, Jeta e Re dhe Qallapek
- Përfundimi i punimeve në ndërtimin e poligonit sportive në fshatin Dobrajë e Madhe
- Në Dobrajë të Madhe po ashtu gjatë këtij viti është ndërtuar edhe fusha ndihmëse e futbollit
- Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e Palestrës sportive në Lipjan
- Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e Stadiumit të Qytetit “Sami Kelmendi”
- Vazhdimi i Rregullimit të fushës së Futbollit në stadiumin e Magures dhe në ndërtimin e tribunave dhe zhyeshitoreve në stadiumin e futbollit në Dobrajë të Madhe.
- Fillimi i punimeve në ndërtimin e Poligonit sportive në oborrin e Shkollës së Mesme, Gjymnazi “Ulpiana” në Lipjan

STATISTIKAT

Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Hedhur Poshtë	Pezulluar
348	292	53	0	0	0

Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Mungese dokumentacionit	Vërejtje
99	81	589	9	Janë inkasuar 294.50€

Raport për Bibliotekën e Qytetit në Lipjan, Gadime, Shalë

Lexues të rinjë	Përpunim i librit	Lexus në sallën e leximit
1174	2786	5023

DISKUTIME PUBLIKE

Kemi realizuar një diskutim publik me të rinjët e komunës së Lipjanit në muajin shkurt të vitit 2020.

TAKIME TJERA

- Takim me këshillin kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, është mbajtur në Prishtinë ku ishin prezent shumica e Drejtorëve të drejtorateve Kulturës, Rinisë dhe Sportit në nivel vendi.
- Kemi mbajtur takim konsultues me përfaqësuesit e klubeve sportive,
- Kemi pasur takim me OJQ, përfaqësues të subjekteve politike dhe të shoqërisë civile, ky takim është organizuar në bashkëpunim me zyren e OSCE-së, në Lipjan, tema e takimit kishte të bënte prezantimi Plani i Verpimi Rinor Lokal 2019-2021, ku morem edhe disa rekomandime nga të pranishmit.
- Kemi zhvilluar takim me UNDP ku është diskutuar raportet në mes të komuniteteve, ku ishin prezente përfaqësues nga Drejtorati i Urbanizmit, Drejtorati i Arsimit dhe zyra për Komunitete,
- Drejtorati ynë në vazhdimësi ka mbajtur takime me klubet sportive dhe Ojq kulturore dhe rinore, duke i mbështetur në të gjitha mënyrat e mundshme.
- Jemi takuar me zyrtarë të organizatës “Play International” për një bashkëpunim të mundshëm me komunën e Lipjanit
- Kemi takuar zyrtarë të projektit për Trashëgiminë Kulturore në regionin e Prishtinës, e financuar nga Banka Botërore, për mundësinë e bashkëpunimit
- Kemi vazhduar takimet dhe aktivitetet me OJQ, por duke respektuar udhëzimet e IKSHPK-së, shumicën e aktiviteteve i kemi realizuar në platformat online.
- Kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore, për të biseduar rreth projektit Komunitat për Rini në Kosovë,
- Kemi realizuar takimin online me UNICEF Kosovën, me temë Plani i punës mes-vjecar dhe 100 ditët e para të pandemisë Covid – 19,
- Kemi zhvilluar takimet me UBT dhe kemi filluar regjistrimin e librave të bibliotekës,
- Kemi takuar të rinjët pjesëmarrës në trajnimin e shkollës Infinit të cilët realizuan aktivitetin e tyre në objektin e bibliotekës së qytetit të Lipjanit
- Kemi takuar organizatën FIQ (Forum i Iniciativë Qytetare), për mundësinë e arritjes së një marrëveshje për ndihmën e realizimit të projektit Biblioteka Digjitale në qytetin e Lipjanit.

SFIDAT

- Sfida nga sektori i kulturës mbetet formimi i trupave artistike, me ndarje të një buxheti vetëm për këtë kategori.

DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka siguruar implementimin e plotë të Ligjit mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, Ligjin mbi prokurimin Publik Nr. 04-L-042, Rregullat Financiare dhe legjislacionin tjetër në fuqi për menaxhimin e parasë publike.

Ky raport përfshinë të dhënat vjetore nga sektorët e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa si:

- Sektori i Buxhetit dhe Financave duke përfshirë edhe të dhënat nga Regjistrimi i Pasurisë Komunale dhe Arka,
- Sektori i Thesarit dhe
- Sektori i Tatimit në Pronë.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Sektori për Buxhet dhe Financa

Në përputhje me legjislacionin në fuqi Sektori për Buxhet dhe Financa:

- Përgaditë Pasqyrat financiare.
- Përgaditë planin e rrjedhës së parasë.
- Përgaditë propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake nga viti paraprak në vitin vijues.
- Përgaditë raporte dhe njofton drejtoritë mbi ecurinë e shpenzimeve përmes programit "Free Balance".
- Përgaditë raporte tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore për Kuvendin Komunal.
- Përgaditë Planifikimin e Buxhetit në bazë të qarkoreve buxhetore-KAB.
- Alokimin e mjeteve.
- Zotimin e mjeteve.
- Regjistrimin e të hyrave në SIMFK, kërkesen për alokimin e të hyrave, barazimin me Thesar-MF. barazimin e të hyrave me drejtorate.
- Evidentimin dhe regjistrimin e pasurisë komunale.
- Inkasimet dhe raportimet nga arka.

Sektori i Thesarit

Objektiv parësor i Sektorit të Thesarit është kryerja dhe procesimi i lëndëve në kohë dhe në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi si dhe përshkrimi i procedurave:

- Për aprovim të shpenzimeve në sistemin e SIMFK.
- Qertifikimin e lëndëve të të gjitha drejtorive.
- Evidentimin dhe regjistrimin e shpenzimeve sipas fondeve, programeve, kodeve dhe kategorive ekonomike.
- Arkivimi i lëndëve.

Sektori i Tatimit në Pronë

Në përputhje me Ligjin e tatimit në Pronën e Paluejtëshme dhe akteve nënligjore, Rregulloren komunale për caktimin e Shkallës Tatimore - Sektori i Tatimit në Pronë:

- Bën evidentimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pronës së paluejtëshme.
- Regjistrimin e pronave të reja.
- Futjen e të dhënave në sistemin e tatimit në pronë.
- Modifikimin e pronave të regjistruara të tatimpaguesëve.
- Shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesëve.
- Shqyrtimi i lëndëve sipas ankesave të paraqitura nga tatimpaguesit, verifikimi në teren.
- Lëshon qertifikatë-vertetim për kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë sipas kërkesës së tatimpaguesëve (qertifikata të ndryshme).
- Regjistrimi i kontratave të shitëblerjës në programin e tatimit në pronë.
- Marrëveshje me tatimpagues për kryeje të obligimit në tatim në pronë.
- Shtypja e faturave për nevojat e tatimpaguesëve nga Zyra e tatimit në pronë.
- Te hyrat e realizuara nga tatimi në pronë.

STATISTIKAT

1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

Gjatë vitit 2020 ky sektor ka përgatitur dhe dorëzuar Pasqyrat Financiare, ka përgatitur dhe dorëzuar Planin e punës për vitin 2020, raportin e punës për vitin 2019 si dhe ka përgatitur raportet vjetor për Asambleen Komunale për Shpenzimin e Buxhetit 2019 dhe Realizimin e të hyrave vetanake të planifikuara për Vitin 2019.

Alokimi i mjeteve

Alokimi i mjeteve nga granti qeveritar (10) ka filluar në janar 2020. Për arsye të mos aprovimit të buxhetit në Kuvendin e Kosovës buxheti në tre muajt e parë është alokuar 1/12 nga viti paraprak. Pas aprovimit të buxhetit alokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë është bërë në periudha tremujore, sic është kërkuar me planin e rrjedhës së parasë.

Të gjitha Drejtoratet dhe ZKA janë njoftuar me kohë për alokimin e mjeteve me qëllim të incimit të kërkesave për zotim të mjeteve. Kërkesat mujore janë dërguar me rregull në Thesar Qendrorë për alokimin e të hyrave vetanake.

Zotimet e mjeteve

Zotimi i mjeteve ka filluar pas alokimit të pjesës së parë të buxhetit.

Në baza të rregullta është përcjellur rrjedha e zotimeve dhe shpenzimi i mjeteve në zotim, në mënyrë të rregullt i është raportuar menaxhmentit dhe drejtorateve rreth gjendjes së mjeteve në zotim dhe shpenzimit të këtyre mjeteve.

Zotimi për kategorinë pasuri jofinanciare (investime kapitale), është bërë nga muaji Mars 2020 deri më 31.10.2020, bazuar në Rregullorën për Përfundimin e Vitit Fiskal MF-Nr 02- 2014, është mbyllur afati për zotim të mjeteve në këtë kategori.

Zotimi për kategorinë Mallra dhe Shërbime është bërë nga muaji Janar 2020 deri më 26.11.2020, bazuar në Rregullin për Përfundimin e Vitit Fiskal MF-Nr 02- 2014, është mbyllur afati për zotim të mjeteve në këtë kategori.

Zotimet për Kategoritë Komunali dhe Subvencione janë bërë prej muajit Janar 2020 deri më 12.12.2020 ku bazuar në Rregullën Finaciare për Përfundimin e Vitit Fiskal MF-Nr 02- 2014, është mbyllur afati për zotim të mjeteve në këto kategori.

Sipas rregullores për përfundimin e vitit fiskal MF-Nr 02- 2014 afati i fundit për regjistrimin e pagesave ka qenë 24.12.2020, ndërsa, afati i fundit për certifikimin e pagesave ka qenë 26.12.2020.

Bartja e të Hyrave Vetanake të pa shpenzuara të vitit 2019 në vitin 2020

Është përgaditur dhe dorëzuar propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020, si dhe është aprovuar në seancën e Asamblesë Komunale të muajit shkurt në shumë prej 980,932.30€.

Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2018 dhe 2019 në vitin 2020 bëhet në këto programe dhe kategori ekonomike.:

-Mallra dhe sherbime	125,577.69 €
-Shpenzime komunale	24,542.55 €
-Subvencione dhe transfere	18,024.50 €
-Pasuritë jofinanciare	812,787.56 €

Pranimi i Qarkores së Parë Buxhetore

Qarkorja e parë buxhetore na është dorëzuar nga MF në Maj 2020 e cila ka pasur për qëllim ofrimin e kufijëve fillestarë të financimit të Buxhetit, afatet kohore për përgatitjen e buxhetit të propozuar dhe kërkesat për ndarjet buxhetore për vitet 2021-2023.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023

Që nga Pranimi i Qarkores së Parë Buxhetore kemi punuar në zhvillimin dhe përpilimin e KAB-it. 2021-2023. Përveç kësaj janë shqyrtuar prioritetet e Buxhetit Komunal, duke punuar ngushtë me Drejtoratet në vendosjen e kufijve të brendshëm buxhetorë në përputhje me Financimin Komunal me Qarkoren e Parë Buxhetore.

Në KAB-in 2021-2023 janë planifikuar shpenzimet e përgjithshme Komunale 2021-2023 sipas kategorive ekonomike. Pas konsultimeve të shumta me drejtorët e drejtorateve hollësisht janë analizuar investimet të cilat do të bëhen në vitin 2021-2023. Gjatë muajit Qershor 2020 KAB-i është analizuar në strukturat Komunale dhe është prezantuar në Bordin e Drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete dhe strukturat e grupet tjera.

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023 është aprovuar në Asamblenë Komunale në Qershor 2020.

Qarkorja e Dytë Buxhetore

Qarkorja e Dytë Buxhetore është pranuar nga Ministria e Financave në Gusht 2020. Kjo qarkore është shpërndarë te Drejtoritë Komunale të angazhuara në hartimin e Buxhetit 2021-2023.

Bazuar në udhëzimet e dhëna me këtë qarkore buxhetore, në masën e planifikuar monetare për paga dhe medetje është përfshirë kostoja e përvojës së punës 0.5% të pagës bazë për cdo vit pune.

Sipas Qarkores Buxhetore , struktura e shpenzimeve për Buxhetin Komunal për vitin 2021 ka qenë si vijon:

Buxheti për vitet 2021-2023 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2021	VITI 2022	VITI 2023
Grant i Përgjithshëm	5,723,937.00	6,012,093.00	6,294,575.00
Grant Specifik i Arsimit	6,916,540.00	7,563,566.00	7,595,510.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	1,996,362.00	3,087,960.00	3,103,400.00

Të hyrat vetanake	1,907,316.00	2,161,247.00	2,260,817.00
Financimi Shërbimet Rezedenciale	175,000.00	175,000.00	175,000.00
TOTALI	16,719,155.00	18,999,866.00	19,429,302.00

Mjetet financiare shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2021	VITI 2022	VITI 2023
Paga e Mëditje	9,574,000.00	9,600,424.00	9,648,426.00
Mallra dhe Shërbime	1,700,000.00	1,774,799.00	1,742,025.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	280,000.00	284,402.00	296,252.00
Subvencione dhe Transfere	500,000.00	532,829.00	564,172.00
Investime Kapitale	4,665,155.00	6,807,412.00	7,178,427.00
TOTALI	16,719,155.00	18,999,866.00	19,429,302.00

Përgaditja, Planifikimi dhe Aprovimi i Buxhetit 2021-2023

Në fillim të Pandemisë aksioni jonë ka qenë inspektimi dhe kontrollimi i mullinjëve duke i verifikuar njësitë matëse-vagat. Ju kemi bërë presion të gjithë pronarëve që mos ta ngrisin çmimin e miellit me që disa tentuan ti ngrisin çmimet. Për shkak të mosrespektimit të dy furrave të bukës me ngritje çmimi i kemi gjobitë të dy furrat dhe javë kemi kthyer çmimi në 0.30 cent sa ka qenë. Gjatë kësaj periudhe jemi angazhuar maksimalisht në respektimin e masave anti covid të ndërmarrura nga Qeveria.

Kështu çdo ditë kemi bërë kontrollimin e:

- a) Supermarketeve ushqimore
- b) Depove dhe qendrave tregtare

- c) Barnatoreve humane
- d) Transportuesve publik, auto-taxit.

Të gjithë personave me covid-19 me Ligj mbi Pandeminë Covid-19 janë urdhëruar inspektorët sanitarë të bëjnë Vendim për vetizolim brenda dite. Kjo punë ka qenë mirë e koordinuara mes IKSHPK me QKMF të Lipjanit ku për çdo ditë kanë dërguar rezultatet e testeve.

-Gjatë vitit janë mbyllur 9 lokale afariste për mosrespektim të ligjeve.

-Gjoha mandatore gjatë vitit kapin vlerën 23,750.00 €, nga ana inspektoreve sanitar.

-Të hyra gjatë vitit nga pranimet teknike kanë qenë 1,200.00€

-Mall i asgjësuar gjatë vitit me kërkesën e pronarëve i cili ishte tubuar nga pikat shitëse në depo, kap vlerën 36,646.00€.

DISKUTIMET PUBLIKE

Për shkak të pandemisë Covid-19 nuk kemi mbajtur takime publike, me që një gjë e tillë ka qenë e ndaluar. Zakonisht me pronarët e bizneseve takimet i kemi pasur individuale por edhe përmes telefonit.

TAKIME TË TJERA

Takimet tjera i kemi mbajtur në mënyrë virtuale.

Disa nga takimet i kemi zhvilluar në objektin e biznesit sa herë që kemi qenë në kontroll.

Kemi zhvilluar edhe takime me Qeverinë, me ministrat: Shëndetësisë dhe MTI-së.

SFIDAT

Sfidë e madhe për inspektoratin ka qenë parandalimi i përhapjes së virusit korona, kontrollimi i respektimit të masave të Qeverisë, MSH-së dhe rekomandimeve të IKSHPK-së, që duke u mbajtur maskën dhe distancën si dhe duke mbajtur higjienën personale ta parandalojmë përhapjen e pandemisë.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspekte	Inspekte me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Vendime për vetizolim	Vendime për shfuqizim	Personat e vdekur nga Covid-19	Inspektim i kafshëve në thertore	Eks-humim	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohshme e lokaleve	Inspekte rreth orarit të punës	Pëlqime sanitare	Punë me pal, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende të pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Gjoha mandatore €	Inspektim i bizneseve për respektimin masave COVID-19	Inspektim të tokave, korje shirjeve, farëra, plehra dhe pylltari	Te hyra nga pranime teknike	Inspekte rreth orarit të punës	Kallëzime penale	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik	Asgjësim i mallit me kërkesë të palës	Mall me afat të skaduar
Biznesi	6206	405	107	458							9	560		455		5	5000	1987		1200€	560		96	198	1248	118		
Ambient	227	73		10						7				88		6						1		3	39			
Sanitarët	7459	179		1155	1244	645	32	183	1			12	28			13160	2486							36	1458		36.646.99€	94.5€
Bujqësia	1402	380		442						50				150			4500€		300							80		
Ndërtimi	994	129		789						36				14		5	3450€					4		17				
Trafiku	1679	190		784						257				137	25	7	2640€					1	49	8	221			
Gjithsej	17967	1356	107	3638	1244	645	32	183	1	350	9	560	12	872	25	23	23750	4473	300	1200	560	6	145	262	3046	118	36.646.99€	94.5€

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Viti 2020 ndryshoi rrjedhën e natyrës së punës jo vetëm në Komunën e Lipjanit por edhe në gjithë vendin. Megjithatë, me mobilizimin e strukturave përgjegjëse në Komunë, me zbatimin e gjitha masave nga MSH dhe rekomandimet e IKSHPK, mund të themi se situata është menaxhuar mirë. Pas angazhimit ndaj Pandemisë, ne kemi arritur të përfundojmë pothuajse gjitha punët e planifikuara më herët, qoftë investime kapitale, kontratë kornizë por edhe shumë investime në mallëra dhe shërbime për menaxhimin e Pandemisë.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, gjatë vitit 2020 gjithmonë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe Planin Orientues ka zhvilluar aktivitetet e saj të cilat janë të planifikuara në buxhetin e Komunës, por krahas kësaj edhe shumë punë dhe zhvillime tjera si rrjedhojë e koronavirusit.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Komuna e Lipjanit përkundër të gjitha vështirësive të shfaqura i ka kushtuar prioritet Shëndetit Publik dhe menagjimit të periudhës me Pandeminë.

Po ashtu është përkushtuar në vazhdimësi në realizimin e projekteve për përmirësimin e kushteve dhe krijimin e hapësirave më të mira, ofrimin e shërbimeve sa më të qasshme dhe sa më cilësore si dhe sigurimin e aparaturave moderne, të cilat do t'i paraqesim më poshtë!

Pasqyra e Pandemisë në Komunën e Lipjanit

- **Prej fillimit të Pandemisë e deri me datë 31.12.2020, bazuar gjithnjë në rezultatet e rregullta të IKSHPK, në Komunën tonë janë identifikuar 1388 raste pozitive, 1069 të shëruar, 26 të vdekur dhe 293 raste aktive!**
- Staf shëndetësor dhe staf mbështetës i prekur me Covid -19 prej fillimit deri në fund të vitit: **15 mjek, 27 staf i mesëm – infermier dhe 2 nga stafi mbështetës!**
- Ndësa gjithsejt gjatë tërë vitit qysh prej fillimit të Pandemisë janë dhënë **8217 infusione** në QKMF, QMF dhe AMF, duke mos llogaritur nurmin e infusioneve që janë dhënë në shtëpi!
- Staf i prekur në **QPS, gjithsejt 4**, ndërsa në Shtëpinë e Komunitetit asnjë rast.

Veprimet e ndermarrura me rastin e shpalljes së pandemisë Sars-Cov-2(Covid-19)

- Jemi furnizuar me maska mbrojtëse dhe pajisje tjera mbrojtëse personale për stafin vazhdimisht
- Është shpërndarë sapun i lëngshëm në të gjitha ordinancat për dezinfektimin e duarëve, po ashtu edhe me letër për dispanzer, vazhdimisht
- Jemi furnizuar me disponzer për letër dhe disponzer për dezinfektues
- Jemi furnizuar me pompa për dezinfektim
- Jemi furnizuar me tunelin dezinfektues
- Jemi furnizuar përmes kontratës kornizë me barna dhe material medicinal për nevojat e QKMF-së.

- Jemi furnizuar me pajisjet mjekësore sipas kontratës dy vjeqare: me **9 aparate** për prodhimin e Oksigjenit, aparate këto shumë të domosdoshme në kohën e Pandemisë dhe janë shpërndarë në Shërbimin e urgjencës, të Infusionet, në Maternitet, në gjitha QMF-të dhe disa AMF.
- Jemi furnizuar me aparate të EKG –së, si dhe aparate defibrillator
- Jemi furnizuar me numërues hematologjik dhe banjo ujore për laboratorët në QMF dhe janë shpërndarë në gjitha QMF – të
- Jemi furnizuar me aparatën CTG për Maternitet
- Jemi furnizuar me Aspirator kirurgjik
- Jemi furnizuar me bombola të Oxygenit
- Janë mirëmbajtur dhe janë shtuar edhe disa kamera në disa pjesë të QKMF

Investimet Kapitale:

- Renovimi i AMF – Babush
- Renovimi i pjesërishtëm i QMF – së Janjevë
- Renovimi i nxemjes në QMF Gadime dhe Magurë
- Renovimi dhe instalimi i nxemjes në AMF- Dobrajë, Babush, Kraishtë, Rubovc
- Blerja e interierit për QKMF, Maternitet dhe Stomatologji
- Furnizimi me 16 shtretër elektrik, kryesisht për shërbimet e infusioneve, në Maternitet, Urgjencë dhe QKMF
- Furnizimi me dyshekët për shtretër
- Furnizimi me pajisje, me jastëk dhe mbulesa për shtrata të pacientëve
- Furnizimi me uniforma për stafin mjekësor dhe stafin mbështetës
- Furnizimi me dyerë druri dhe vendosja e tyre në vendet sipas nevojës
- Furnizimi me inventar të ri për gjitha ordinancat (tavolina pune, dollap, paravana, varëse, otomana, karrika për pacient, karrika për pritore, tavolina të vogëla për pritore etj)
- Asfaltimi dhe rregullimi i oborrit të QKMF –së
- Projekti zvicerran AQH – Renovimi i QMF –së Magurë, AMF- Sllovi dhe AMF – Kraishtë
- Projekti i fituar nga AQH – përmirësimi i kushteve në QMF – Magurë,
- Furnizimi me materiale për shërbimet shëndetësore të integruara nga AQH
- Ndërtimi i annex-objektit në Shtëpinë e Komunitetit

Shërbime të reja të ofrimit të shërbimeve shëndetësore nga KPSH-Lipjan për vitin 2020:

1. Konsulta online përmes rrjeteve sociale (viber) dhe me telefon.
2. Kujdesi paliativ dhe kujdesi në shtëpi për pacientet e infektuar me COVID-19
3. Adaptimi i objektit të maternitetit në shërbim ditor për trajtimin e pacientëve COVID-19
4. Shërbime shëndetësore të integruara dhe pakoja bazike e shërbimeve shëndetësore për Hipertension dhe Diabet në perkrahje dhe trajnime nga AQH

Donacionet në Shëndetësi

1. Ministria e Shëndetësisë i ka dhuruar QKMF së – një aparat që prodhon O₂ në kapacitet prej 10 litrave
2. Donacione me mjete mbrojtëse nga KFOR-I, FSK-JA, BIK-u, qytetarë, operator, OJQ etj.
3. Donacion nga UNICEF-i automjetin Ford për shërbimet shëndetësore, dhe shërbimin për nana dhe fëmijë deri në 3 vjet
4. Donacion nga FSK, otoman për AMF-Dobrajë

5. Donacion nga AQH- mjete mbrojtëse personale për stafin
6. Donacion nga MADEKOS, maska, dorëza, dezinfektant, syze, mantila njëpërdorimshme etj
7. Donacion me barna nga kompania farmaceutike Omega Pharm
8. Donacion me maska mbrojtëse nga disa rrobaqepëse të Komunës
9. Racione ushqimore për stafin nga afaristët në Komunë.

STATISTIKAT

Përmbledhje e vizitave dhe shërbimeve mjekësore ne QKMF, QMF dhe AMF-Lipjan

01	Vizita mjekësore në QKMF	85634
02	Vizita mjekësore në Punte	48132
03	Vizita në shërbimin e urgjencës	33769
04	Vizita në sektorin e stomatologjisë	8847
05	Vizita gjinekologjike në maternitet	4198
06	Vizita pediatrike	3085
07	Vizita pulmologjike në dispanzerin e mushkrive	221
08	Vizita mjekësore në kujdesin paliativ	1191
09	Gjithsej vizita mjekësore	185077

Shërbimet shëndetësore

10	Gjithsej injeksione	76420
11	Gjithsej infuzjone	28834
12	Gjithsej lidhje-pasrim plage	12962
13	Gjithsej Rtg exponime	5191
14	Gjithsej pacient ne laborator	16745
15	Gjithsej lindje	10
16	Gjithsej EKG	3605
17	Gjithsej Mamograf	0
18	Gjithsej USG	922
19	Gjithsej vizita shtëpijake	672
20	Gjithsej transport me autoambulanc	761
21	Gjithsej Imobilizime	343
22	Gjithsej Oksigjenoterapi	863
23	Gjithsej Largim I Penjëve	770
24	Gjithsej aksident trafiku	156
25	Këshillimorja	1465
26	Gjithsej referime	17954
27	Gjithsej vakcina	21881
28	Infuzione për pacient me Covid-19	8217
29	Vaksinimi në shkolla dhe shërbime tjera në KPSH	50096
30	Gjithsej shërbime	247867
31	Perqindja e referimeve	9.70%

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Në sektorin e mjekësisë familjare: Puna me mjekë ka qenë e organizuar sipas rrethanave të reja me pandeminë duke e kursyer stafin nga ekspozimi sipas rekomandimeve të MSh dhe IKShPK, mbulimi i te gjitha punkteve përveç gjate sezonit të verës ku stafi shfrytëzon pushimin vjetor dhe nuk ishte e mundur të mbulohen te gjitha punktet shëndetësore.

Stafi i mesëm i Infermierisë: Është arritur koordinimi i mirë në organizimin dhe shpërndarjen e punëve gjatë gjithë kohës së Pandemisë, si në kryerjen e raportimeve me kohë, planifikimin dhe shfrytëzimin e pushimeve pa penguar procesin e punës, si dhe mbajtja e disa takimeve radhazi lidhur me përmirësimin e cilësisë së punës infermiere në bashkëpunim me drejtorinë dhe koordinatoren e QEV-it.

Në sektorin e barnatore: Kemi një përmirësim në shpërndarjen, planifikimin si dhe evidentimin e stokut. Barnatorja është e pajisur me higroskop, klimë, termometra për ambientit të deponimit të barnave dhe frigoriferëve!

Furnizimi me barna nga të hyrat vetanake dhe donacionet ka qenë shumë i mirë. Gjithashtu edhe furnizimi me barna nga lista esenciale në Barnatoren Qendrore nga MSH është i mirë me rreth **65%- 70%**

Është kryer planifikimi për vitin 2021. Kemi krijuar dosjet për secilin pacient që përdorin barnat për diabet, neuroleptik dhe barna psikotrope

Pacient insulinë varës janë rreth 330, kurse me tabletave mbi 1500

Në sektorin e shërbimit të Urgjencës:

Shërbimi i urgjencës ofron shërbime 24 ore në ditë. Ky shërbim është i ngarkuar me numër të madh të pacientëve dhe kështu edhe shpenzuesi më i madh ku më shumë se gjysma e furnizimit me material mjekësor dhe terapi shpenzohet nga ky shërbim.

Në sektorin e Stomatologjisë: Pas disa renovimeve në këtë shërbim si dhe pajisjen me karrige stomatologjike sipas planifikimit presim në përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e numrit të vizitave stomatologjike. Kemi kryer servisimin e disa aparaturave përfshi edhe Rtg të dhëmbëve e cila është kthyer në funksion.

Në sektorin e Maternitetit: Ky shërbim ka shënuar rënie të lindjeve, por tani e kemi orientuar vizitat dhe këshillat për nëna dhe fëmijë deri në tre vjeç, dhe jemi duke realizuar vizita shtëpiake, kurse vizitat gjinekologjike-obstetrike kryhen nga dy mjekë gjinekolog. Renovimi i objektit ka përmirësuar dukshëm kushtet e punës si dhe pajisja me ECHO dhe CTG.

Në sektorin e Pneumoftiziologjisë: Kemi zvogëlim të numrit të sëmurëve me TB, për katër raste me pak se në vitin 2019, shërbimi funksionon pa ndonjë ndryshim të veçantë .

Në vitin 2020 ka regjistruar gjithsej **23** pacient.

Në sektorin e vaksinimit dhe SISH-it: Përveç realizimit të vaksinimit sipas planifikimit kemi kryer edhe vaksinimin e 3300 qytetarëve me prioritet për marrjen e vaksinës së gripit.

Në sektorin e Laboratorit: Kemi një aparaturë të mirë, furnizimi me numërues hematologjisë të ri, si dhe duhet theksuar se gjatë vitit nuk kemi pas vështirësi në furnizim me material laboratorik, po ashtu furnizimi me aparaturë të re edhe në katër QMF ka ndikuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Në sektorin e mirëmbajtjes: janë kryer një numër i madh i punëve, ndër me më rendësi janë:

1. Mbikëqyrja e kontraktit për ndërrimin e kalldasë dhe radiatorëve dhe gypave të sistemit të ngrohjes në QMF-Gadime, AMF-Dobrajë, Rubofc dhe Babush (nga sistemi me thëngjill në sistemin me pelet dhe rrymë),
2. Mbikëqyrja e kryerjes së punëve në renovimin e QMF-Magurë dhe AMF-ve-Dobrajë, Rubofc dhe Babush.
3. Mbikëqyrja e projektit nga AQH (ndërtimi i recepcionit dhe adaptimi i hapsirave për vendosjen e ordinancës dhe pushimores në QMF-Magure)
4. Ndërrimi i rubineteve dhe riparime në QMF, Shalë, Magure, Janjevë, etj.
5. Pastrimi dhe mirëmbajtja e oborrit të QKMF-se dhe punkteve.
6. Planifikimi për investime dhe renovime vitin 2021, përcjellja e punëve në renovimin e objektit të emergjencës dhe stomatologjisë,
7. Mbikëqyrja me përgjegjësi e realizimit të furnizimeve dhe renovimit.
8. Sigurimi me kohë i lendeve për ngrohje si dhe ngrohja e mirë në të gjitha objektet e QKMF dhe punkteve.

Në sektorin e autogarazhes: Kemi rënie të shpenzimeve të derivateve, por kemi edhe një orar të ri me pacientet e hemodializës si dhe shtimin e pacientëve të ri. Formimin e komisionit për vërtetimin dhe evidentimin e shpenzimeve të derivateve në automjetet e QKMF-së. Servisim me kohe dhe mbajtje në funksion të mirë të gjitha automjetet e QKMF-së, Përkrahja me autoambulancë dhe ekip mjekësorë e disa evenimenteve sportive.

Departamenti i Administratës

Nr. Rend	Emërtimi i Aktit	Nr. i akteve
1	Aktvendime për shfrytëzim të pushimit vjetor	150
2	Aktvendime për pagesën e punës së natës, jashtë orarit, festës	33
3	Aktvendime mbi masat disiplinore	1
4	Lëshime të vërtetimeve për provojë të punës për ish punëtorët dhe punëtorëve aktual	43
5	Evidentimi dhe procedimi i pushimeve mjekësore	37
6	Evidentimi dhe procedimi i lindjeve në njësinë e maternitetit	/
7	Aktvendimet për pushimet e Lehonisë për punëtorët	5
8	Largim nga puna me vetë dëshirë dhe të larguar me procedurë të rregullt	5
9	Largim nga puna sipas procedurës disiplinore	1
10	Pushimet pa pagesë	10
11	Rekrutime të reja të punëtorëve	8

12	Vërtetime që kanë përfunduar praktiken në QKMF	40
13	Vërtetime që kanë qenë në praktik vullnetare në QKMF	3
14	Aktvendime për daljen në pension të punëtorëve	1
15	Aktvendim për ndërprerjen e punës së punëtorëve që kanë vdekur	/
16	Aktvendime të ndryshme dhe shkresa të ndryshme .	32
17	Ndryshime në listën e pagave të punëtorëve për vitin 2018	160
Gjithësej:	Lëndet e punuara janë:	529

Edukimi Posdiplomik Specialistik:

Në kuadër të Edukimit specialistik nga QKMF-Lipjan janë dy (2) mjekë në specializim të Mjekësisë Familjare, ku pas përfundimit të këtyre specializimeve Komuna jonë do të jetë ndër Komunitat e para që i afrohet planit strategjik kombëtar një Mjek Familjar në 2000- 2500 banorë.

Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)

1. Në kuadër të ZHVP-së është zhvilluar trajnimi me stafin për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale (PPE), po ashtu edhe njohuritë lidhur me Sars-Cov-2, trajnime të cilat janë kryer pas trajnimit të trajnerit nga MSh OJQ HOPE dhe Universiteti Brown nga ShBA.
2. Shkolla verore në Universitetin e Lluganos Online (LSS)
3. Dita botërore kundër diabetit 14. Nëntor 2019
4. Dita kundër HIV/AIDS 1 dhjetor 2019
5. Dita botërore e Zemrës
6. Ka pas prezantim të produkteve të reja farmaceutike nga prodhues të huaj.
7. Trajnimi për menaxhim të cilësisë me AQH-Projektin.

• Raporti mjekë infermier/e

- Raporti mjek: Infermier (mami dhe laborant) është **53:137** apo **1: 2.58**
- Mjek për banorë në Komunën e Lipjanit, Mjekë Familjar/Mjekë i Përgjithshëm **42**
- **40:58800** apo **1 Mjekë F/MP : 1400 Banorë**
- **1 Stomatolog : 5880 Banorë**
- **Raporti mjek- infermier 1: 2,28**
- Infermier/e 128. **128** Infermier/e : **58800** Banorë , **1**Infermier/e : **459.37** Banorë
- Gjithsej punëtorë **232**
- Nivel vendi ky raport llogaritet të jetë
- **1 mjekë F/MP : 2000-2500 banorë**
- **1 infermier/e : 1000 banorë**
- QKMF-Lipjan ka një kuadër të specializuar **Mjekë Familjar 27,**

Konsulent (Specialist të lëmvë tjera): Një mjek Pediatër, dy mjek Gjinekolog dhe një Radiolog,

Stomatolog. Gjithsej 11 stomatolog (nga këta katër specialist të stomatologjisë)

Konkluzione:

1. Viti 2020 ka qenë një sfidë e vërtetë për të gjithë stafin mjekësor dhe mbështetës në tejkalimin e pandemisë Covid-19. Njohurit e pakta fillimisht për virusin Sars-Cov-2, mungesa e PPE në fillim të pandemisë.
2. Stafi i infektuar gjatë vitit 2020 me Sars-Cov-2 ka qenë 42 deri me 31.12.2020
3. Investime kapitale kanë qenë më të larta se deri më tani dhe kanë përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore
4. Furnizimi me barna, PPE dhe materiale medicinale ka qenë shumë më i mirë se vitet e më parëshme.
5. Investime në mallëra dhe shërbime ka qenë shumë më i lartë se vitet e mëparëshme

Pasqyra totale e kërkesave për vitin 2020

	Lloji i kërkesës	Të pranuar	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë
1	Kërkesa për Strehim në Strehimoren Magure	10	/	10	/
2	Kërkesat për vazhdimin e kontratave për banim në Strehimore	18	18	/	/
3	Kërkesa për ndërtim,meremetim të shtëpive	56	12	43	1
4	Kërkesa për ndarje të banesave	/	/	/	/
5	Kërkesa nga QKMF	43	35	8	/
6	Kërkesa nga QPS	33	33	/	/
7	Kërkesa nga Shtëpia e Komuniteteve	38	38	/	/
8	Kërkesa për mjete financiare	343	149	194	/
9	Kërkesa për shërim jashtë vendit	10	10	/	/
10	Kërkesa për realizimin e të drejtave të familjeve të veteraneve të luftës së UÇK,dëshmore,invalidëve,viktimave civile.	6	6	/	/
11	Kërkesa për certifikata të shitesave femërore për punëtorët në botën e jashtme.	31	31	/	/
12	Aktvendime për pagesën e punëve jashtë orarit të punës për Shtëpinë e Komuniteteve	33	33	/	/
13	Aktvendime për pushim pa pagë në QKMF	10	10	/	/
14	Aktvendime për vazhdimin e qëndrimit të rezidentëve në Shtëpinë e Komuniteteve	10	10	/	/
15	Aktvendime për pushim pa pagë në Shtëpinë e Komuniteteve	/	/	/	/
16	Kërkesa për punësim në QKMF				/
17	Kërkesa për punësim në Shtëpinë e Komuniteteve	4	1	3	/
18	Kërkesa për praktik në QKMF	248	195	53	/
19	Kërkesa për pagë jubilarë nga punëtorët e QKMF-së	15	/	15	/

20	Ankesa për pagë jubilarë për punëtorët e QKMF-së	15	/	/	15
21	Vërtetime të ndryshme	63	63	/	/
22	Kërkesa të ndryshme	70	70	/	/
23	Nr.i përgjithëshum i kërkesave	1056	714	326	16

QPS – STATISTIKAT

Numri i përrfituesve nga skema e strehimit familjar.

Nr .	Muaji	Femije me nevoja te veqanta	Vlera per person	Shuma
1.	Janar	21	100	2,100.00 euro
2.	Shkurt	21	100	2,100.00 euro
3.	Mars	20	100	2,000.00 euro
4.	Prill	19	100	1,900.00 euro
5.	Maj	19	100	1,900.00 euro
6.	Qershor	18	100	1,800.00 euro
7.	Korrik	18	100	1,800.00 euro
8.	Gusht	18	100	1,800.00 euro
9.	Shtator	19	100	1,900.00 euro
10	Tetor	18	100	1,800.00 euro
11	Nentor	17	100	1,700.00 euro
12	Dhjetor	17	100	1,700.00 euro
			Gjithësej	22,500.00 euro

Numri i përfituesve nga skema e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar

Nr.	Muaji	Femije me nevoja te veqanta	Vlera per person	Shuma
1.	Janar	92	100	9,200.00 euro
2.	Shkurt	87	100	8,700.00 euro
3.	Mars	87	100	8,700.00 euro
4.	Prill	87	100	8,700.00 euro
5.	Maj	88	100	8,800.00 euro
6.	Qershor	88	100	8,800.00 euro
7.	Korrik	88	100	8,800.00 euro
8.	Gusht	89	100	8,900.00 euro
9.	Shtator	89	100	8,900.00 euro
10	Tetor	89	100	8,000.00 euro
11	Nentor	90	100	9,000.00 euro
12	Dhjetor	99	100	9,900.00 euro
			Gjithësej	106,400.00 euro

Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindrore (kujdestari) përfitues nga subvencionimi

Nr.	Fëmijë pa kujdes prindëror	Forma e mbrojtjes	Shuma euro për një fëmijë	Gjithëse
1	2	Kujdestari	300 €	7,200 €
2.	1	Familje strehuese	300€	300 €
3	3	Kujdestarei dhe Strehim Familjar	300€	7,500.00€

Numri i përfituesve të ndihmave sociale gjatë 2020

Nr.	Muaji	Numri i familjeve sipas Përkatësisë etnike		Gjithësej Numri I familjeve	Numri I antarëve	Pagesa mujore
		Shqiptare %	Pakicat etnike R.A.E.K.S %			
1.	Janar	1010	200	1210	5501	135,087.50
2.	Shkurt	992	206	1198	5439	138,202.50
3.	Mars	997	199	1196	5455	270,235.00
4.	Prill	1033	210	1243	5672	279,385.00
5.	Maj	1075	211	1286	5694	280,170.00
6.	Qershor	1031	211	1242	5694	138,485.00
7.	Korrik	1041	205	1246	5581	137,292.50
8.	Gusht	1037	202	1239	5532	135,890.00
9.	Shtator	1033	201	1234	5519	136,120.00
10.	Tetor	1042	200	1242	5538	272,920.00
11.	Nëntor	1077	202	1279	5662	281,625.00
12.	Dhjetor	1119	204	1323	5807	287,745.00

Gjithsej: 2,493,175.50 Euro

hërbimet sociale gjatë pandemisë Covid19

PAKOJA E 15 - FISKALE

Muaji	Numri i aplikacioneve	Numri aplikuesëve	Aplikacionet e refuzuara	Shuma e mjeteve
Pril I- Qershor	2728	1283	1445	42,380.00€

Gjithesej 614 ankesa për pakon emergjente fiskale –Masa 15

Totali i përfituesëve nga skemat e zbatuara në QPS gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19.

Skemat:	Asistencë sociale Janar –Dhjetor	Masa - 15	Strehim familjar	S kema PAK
Numri i përfituesve	1210-1279	2447	21	92
Totali në euro	2,493,175.5€	5,00.370.00€	20,600.00€	106,100.00€

Shtëpia me bazë në Komunitet

STRUKTURA E REZIDENTEVE			
NACIONALITETI	NUMRI	FRMRA	MESHKUJ
SHQIPËTARË	8	4	4
ROM	2	2	
BOSHNJAK	1	1	
NUMRI I PERGJITHSHEM	11	7	4

Shtëpia me bazë në Komunitet

Përkundër Pandemisë, gjendja në Shtëpinë e Komunitetit në përgjithësi ka qenë e mirë . Të gjitha punët dhe aktivitetet janë kryer me rekomandim dhe masa të IKSHPK dhe MSH.

Kryerjen e të gjitha obligimeve komunale dhe gjitha obligimeve rreth furnizimeve.

Investime kapitale

Janë pajisur të gjitha dritaret me roleta të jashtme, është kryer ndërtimi i vrazhdë i **aneks objektit** në dy kate, i planifikuar për sallën e aktiviteteve.

DISKUTIME PUBLIKE

Diskutime publike kanë qenë të anuluar për shkak të Pandemisë. Kemi realizuar takime në platformën online kryesisht. Takime të rregullta me Kryetarin dhe me ekzekutivin e Komunës për menaxhimin e situatës për shkak të Pandemisë, poashtu edhe me bordin e drejtorëve për punët e realizuara dhe problemet apo sfidat në realizimin e objektivave të punës dhe menaxhimin sa më të mirë të situatës.

SFIDAT

Pengesa ne rritjen e performancës, apo vështirësitë në QKMF, gjatë vitit 2020 ishin:

Pajisjet e vjetruara mjekësore. (Rtg Aparati, kërrigat stomatologjike, moskryerja e analizave si CRP, ALT, AST, etj).

- Mungesa e automjeteve te mjaftueshme për shërbime te patronazhit dhe vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë, si dhe administratës!

- Mundësia e stimulimit të punëtorëve të mirë dhe punëtorëve në teren.
- Furnizimi i mangët me disa lloje të barnave dhe material medicinal nga MSH.
- Këto janë disa nga pengesat të cilat janë evidente në zvogëlimin e ofrimit të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve shëndetësore në kujdesin primar në komunën e Lipjanit.

Vështirësitë në realizimin e aktiviteteve në QPS.

- ✓ Mungesë e standardeve strukturore në kuadër të kornizës organizative për shërbime sociale.
- ✓ Automjetet e amortizuara dhe në gjendje jo të rregullt, njëra prej tyre jashtë funksionit
- ✓ Mos realizimi material për pagesë të punës në kujdestari.
- ✓ Mos realizim i të drejtës për subvencionim të zyrtarëve që realizuan aktivitete emergjente në zbatimin e Masës 15, të Pakos Emergjente Fiskale.
- ✓ Puna me staf të reduktuar për shkak të pandemisë Covid 19.
- ✓ Përballja e disa zyrtarëve të këtij institucioni me virusin Covid-19.
- ✓ Përballja me numër të shtuar të përfituesve nga skemat sociale, sidomos nga Pakoja Emergjente Fiskale –Masa 15 (për 50%) Angazhimi i zyrtarëve në aktivitete tereni sa i përket gjendjes emergjente, realizim të pakove ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë.
- ✓ Numër të klientëve mbi normativin e punës në kuadër të shërbimit të asistencës Sociale, dhe atë me ngarkesë mbi 100 lëndë.

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Viti 2020 i punës përkon me një periudhë sfiduese të veprimtarisë së DPUMM në përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dispozitat ligjore nga fusha e planifikimit, ndertimit dhe mjedisit.

Gjatë vitit 2020 janë përgaditur dokumentet për prezentim në Kuvendin e Komunës dhe janë aprovuar Propozim Vendimet, si:

- Rregullorja mbi Taksën administrative për Leje ndërtimore, leje rrërimi dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës për vitin 2020.
- Propozim Vendimi – parcela P-71409044-01745-0, ZK Lipjan.
- Vendimi për vënie në shqyrtim Publik të Projek dokumentit: Harta Zonale e Komunës së Lipjanit;
- Propozimi për vënien nën mbrojtje të Lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh.

Angazhimi në Komisione dhe grupe punuese:

- Angazhimi i DPUMM në Komisionin për kthim dhe reintegrim ku janë zhvilluar takime sipas rasteve të prezentuara.
- Angazhimi në kuadër të Grupit punues për Sistemin e performances Komunale lidhur me plotësimin e të dhënave nga fushat: Planifikimi Hapësinor, Hapësirat Publike, Mbrojtja e Ambientit si dhe janë finalizuar të dhënat.
- Në kuadër të Grupit punues është finalizuar dokumenti nga pjesa e procedurës për fushën e planifikimit dhe ndertimit finalizimin e procedurave administrative në kuadër të programit të Bankës botërore për thjeshtëzimin e procedurave administrative.
- Në kuadër të Komisionit për hartimin e programit komunal 3 vjeçar për banim në bashkëpunim me ekspert nga VORAE është hartuar dokumenti në nivel të Draftit, i cili do të procedohet në MEA

për verifikim të aspektit ligjor dhe të drejtën për shpalljen e dokumentit në shqyrtim publik dhe miratimin në Kuvendin e Komunës.

Zhvillimet tjera në kuadër të bashkëpunimit me institucionet dhe tjera:

- DPUMM ka zhvilluar Takim konsultativ me përfaqësues të ATK me qëllim të krijimit të platformës online, si dhe janë përgaditur materiali sipas të dhënave të kërjuara nga ATK – Lejet ndërtimore për vitet 2017, 2018, 2019,
- Është plotësuar Formulari TM4 për periudhën 3 muajore vitin 2019, kërkuar nga ASK.
- Procesi i legalizimit, gjatë kësaj periudhe DPUMM ka informuar Ministrinë lidhur me procesin pranuar dhe plotësuar Pyetësin e prezentuar nga MMPH lidhur me të dhënat për këtë proces nga Komuna.
- Eshtë filluar regjistrimi i lëndëve – Certifikates së Legalizimit në Regjistri elektronik për ndërtimet pa leje, sipas formës së prezentuar nga MEA.
- Bazuar në kërkesën e MEA është përpunuar dhe dorëzuar Pyetësi lidhur me procesin e legalizimit – për periudhën 3 muajore dhe për muajin tetor.
- Seminar online me MEA lidhur me regjistrimin e ndërtimeve pa leje – prezentim i Udhëzuesit.
- Trajnim online i organizuar nga MPL së bashku me DEMOS lidhur me risit në SMPK - Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale .
- Trajnim online i organizuar nga INDEP - Klubit të Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ): Edicioni i Kosovës.
- Plotësim i Pyetësit për çështje të Trashëgimisë Kulturore që ndërlidhen me Zonat e Veçanta të mbrojtura, kërkuar nga OSBE

Duke pasur parasysh kushtet aktuale të shfaqjes së Pandemisë, si Drejtori kemi vendosur lidhur me formën dhe mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të punës në distancë, që nënkupton punë nga shtëpia dhe puna në zyre me staf të reduktuar.

DPUMM nga fillimi i vitit ka zhvilluar aktivitetet normale deri me 13.03.2020, dhe nga kjo datë DPUMM ka funksionuar në mënyrë të reduktuar.

Gjatë muajit mars DPUMM ka vënë në funksion formën e komunikimit me palët dhe të gjithë të interesuarit për punën e DPUMM përmes faqes elektronike.

Muaji mars kryesisht është karakterizuar me kufizim të lëvizjes kështu që kjo ka rezultuar edhe në procesin e punës, duke iu referuar natyrës së punës që është konsideruar si detyrë e natyrës me prioritet, jemi fokusuar kryesisht në shqyrtimin e lëndëve të cilat janë konsideruar si prioritet apo lëndë të cilat mund të përfundohen brenda afatit, dhe lëndë në procedurë finale.

Vitin 2020 padyshim karakterizohet me zhvillimet në kuadër të procesit të HZK, si:

Dokumenti Draft Harta Zonale e Komunës dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor i HZK, janë dorëzuar për shqyrtim dhe vlerësim të ligjshmërisë dhe të drejtën e fillimit të procesit të shqyrtimit publik nga Komuna. Lidhur me këtë DPUMM ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga MEA dhe ka prezentuar dokumentin. Eshtë dhënë Pëlqimi MEA për marrjen e Vendimit në Kuvendin e Komunës për hapjen e shqyrtimit publik ashtu siç e parashef Ligji për Planifikim Hapësinor.

HZK është prezentuar në Kuvendin e Komunës dhe është marrë Vendimi për vënien në shqyrtim Publik të HZK.

Eshtë përgaditur materiali për publikim në faqen zyrtare të Komunës – Harta Zonale Komunës së Lipjanit dhe Raporti i VSM.

Njoftimi për shqyrtim publik i publikuar në faqen zyrtare të Komunës dhe definimi i prezenteve publike gjithsejt 7 prezente publike, 5 në qytetin e Lipjanit dhe dy prezente në zonat rurale, Magurë dhe

Gadime, i cili është zhvilluar nga 18 shtator deri me 19 tetor 2020, në kuadër të të cilave pjesëmarresit kane prezentuar dhe është zhvilluar debate në të cilin jane informuar pjesëmarresit me dokumentin dhe kanë paraqitur vërejtjet e ndryshme në dokument.

Kryesisht vërejtje janë evidentuar në pjesën e Kushteve zhvillimore për zonat si koeficienti i shfrytëzimit të parcelës, sipërfaqja minimale e parcelës, si dhe destinimet në disa zona.

Vërejtjet janë prezentuar edhe në Librin e vërejtjeve si dhe përmes QSHQ.

Në kuadër të Grupit Punues dhe në bashkëpunim me GIZ janë trajtuar të gjitha vërejtjet dhe janë prezentuar në Raportin e shqyrtimit publik i cili është publikuar në faqen zyrtare të Komunës.

Të dhenat nga Raporti i shqyrtimit Publik të HZK për mundësinë e integritit në HZK, në kuadër të finalizimit të dokumentit të HZK dhe VSM si dhe përgaditjet për teknike për dërgim në MEA për dhënien e Pelqimit në këtë faze, janë përgaditur në bashkëpunim me GIZ.

- Në proces të përgaditjes dhe dërgimit në MEA Taksat dhe Tarifat për ndërtim për vitin 2021.

Projektet komunale të cilat janë planifikuar të implementohen për vitin 2020, janë proceduar sipas Planit të prokurimit dhe kërkesave nga Drejtoratet relevante të cilat janë prezentuar në mënyrë tabelare.

Gjatë viti 2020 DPUMM ka pranuar gjithsejt 576 kërkesa të natyrave të ndryshme si dhe kërkesat e bartura nga viti 2019 gjithsejt 18 kërkesa, të cilat janë trajtuar dhe nga totali lëndë të shqyrtuara janë gjithësej 539 lëndë, ndërsa në procedure shqyrtimi janë gjithësejt 55 lëndë (të prezantuara në pjesën tabelare).

Të hyra të realizuara gjatë kësaj periudhe raportuese duke iu referuar te hyrave nga Lejet ndërtimore, ndërrimi i destinimit të tokës, lejet mjedisore komunale, Certifikata legalizimi dhe leje rrënimi janë realizuar:

Gjithsejt të hyra të planifikuara 371,032.00€, të realizuara 439,143.49€ që rezulton në realizim dhe tejkalim të buxhetit total të planifikuar (te prezentuara në pjesën tabelare).

AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periudhës raportuese – viti 2020 DPUMM ka zhvilluar aktivitetet si vijon:

1. Menaxhimi i procesit të implementimit të projekteve komunale në kuadër të procesit të hartimit të projekteve, si dhe bashkëpunimi me Drejtoratet relevante në të gjitha fazat, të prezentuara në formë tabelare.

Nr	Aktiviteti	Emri i projektit	Lokacioni	Të arriturat
I.	IMPLEMENTIMI I PROJEKTEVE KOMUNALE			
A.	DOKUMENTE PLANORE			
1.	Menaxhimi i procesit dhe bashkëpunim me GIZ EKK dhe EKP	Harta Zonale e Komunës	Lipjan	Finalizimi i dokumentit / përgaditja për Pelqim Final
2	Menaxhim i Procesit dhe bashkëpunim me Kompaninë kontraktuese.	Vlerësimi Strategjik Mjedisor i HZK	Lipjan	Draft-dokumenti/
B.	INFRASTRUKTURË RRUGORE			
		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Ribar i Madhë	Ribar i Madhë	Projekti i dorëzuar

1				
2		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Dobraje e Madhe	Dobrajë e Madhe	-//-
3		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Kraishtë	Kraishtë	-//-
4		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Topliqan	Topliqan	-//-
5		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Grackë e Vjetër	Grackë e Vjetër	-//-
6		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Llugë	Llugë	-//-
7		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Qallapek	Qallapek	-//-
8		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Kroimir	Kroimir	-//-
9		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Janjevë	Janjevë	-//-
10	Hartimi i detyrës projektuese dhe bashkëpunimi me Kompaninë projektuese dhe Drejtoratet relevante gjate hartimit te projekteve te planifikura për vitin 2020.	Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Banullë.	Banullë	-//-
11		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Vrellë e Goleshit	Vrellë e Goleshit	-//-
12		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Glllogoc	Glllogoc	-//-
13		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Poturoc	Poturoc	-//-
14		Asfaltimi i rrugicave në vendbanimin Baicë	Baicë	-//-
15		Asfaltimi i rrugës – segmentit “Sadik Shala” Lipjan	Lipjan	-//-
16		Asfaltimi i rrugëve Gadime e Ultë	Gadime e Ultë	
17		Asfaltimi i rrugëve Gadime e Epërme	Gadime e Ultë	
18		Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Akllap	Akllap	
19		Asfaltimi i rruges Gllanice- Torine	Gllanice Torinë	
20		Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Jeta e re/Topliqan	Jeta e Re	
21		Asfaltimi i rrugëve Marevc- Gllavice	Marevc Gllavicë	
22		Asfaltimi i rrugëve ne Bujan	Bujan	
23		Ndertimi i rruges nga fshati Lluga (Lipjan) deri te fshati Radeve (Graqanice)	LLuge-Radevë	
24		Asfaltimi i rrugëve ne Vrelle e Gadimes		
25		Asfaltimin e rruges Rruga transit Lagja Akllapit qe lidhet me rrugen rajonale Lipjan-Janjeve	Lipjan	
26		Asfaltimi i Rrugës segmenti Sllovi-Akllap	Sllovi-Akllap	
27		Ndricimi publik në Sllovi	Sllovi	
28		Trotualet dhe ndricim publik ne Grackë e Vogël dhe Topliqan	Grackë e v. Tolpiqan	

29		Ndërtimi i trotuareve në Babush	Babush	
30		Rikonstruimi i ndriqimit publik në qytetin e Lipjanit	Lipjan	
31		Ndriqimi publik në Leletiq, Vershevc, Hallaq të Madhe, Dobraje e Vogel, Lluge Gllanic, Ribar i Vogel."		
INFRASTRUKTURE TEKNIKE – MJEDIS				
1		Rehabilitimi i rrjetit të Ujësjetit në Krojmir	Krojmir	Ne proces
D	INFRASTRUKURË SHOQËRORE			
1		Infrastruktura në objektet shkollore		Projekti i dorezuar
2		Ndërtimi i Aneksit të shkolles fillore "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan	Lipjan	Finalizuar
3		Ndërtimi i Anexit – Shtëpia me bazë në Komunitet	Lipjan	Finalizuar
4		Renovimi i njeve sanitare në shkollat , Lipjan, Konjuh, Blinaje , Shale, Ribar i Madhe , Varigovc, Medvec		Projekti i dorezuar

Pjesëmarrja në Komisione, Grupe punuese, Seminare dhe takime tjera të ndërlidhura me fushëveprimin e Drejtorisë, të prezantuara në pjesën tabelare në vijim:

III	Aktiviteti	Lloji	Lokacioni	Të arriturat
A	PJESËMARRJA NE KOMISIONE DHE GRUPE PUNUESE			
1	Aktivitetet e DPUMM dhe në kuadër të Komisioneve dhe Grupeve Punuese	Komisioni për kthim dhe reintegrim	Lipjan	Shqyrtim sipas rasteve
2		Pjesëmarrja në Komisionin për palët e interesit në MMPH , projekti i ASHNA	Prishtinë	Finalizuar
3		Sistemi i menaxhimit të performancës komunale	Lipjan	Finalizuar
4		Programi 3 vjeçar Komunal i banimit	Lipjan	Ne proces
5	Takim konsultativ – Grupi Punues	Procedurat administrative – programi i BB	Lipjan	Finalizuar
6	Pjesëmarrja në Komision	Pergaditja e materialit për Kuvend – Propozim për venien në mbrojtje të Lokaliteti i <i>Boshtres (Forsythia europaea)</i> në Golesh	Lipjan	Finalizuar
7		Propozim Vendimi – parcela P-71409044-01745-0 ZK Lipjan	Lipjan	Finalizuar

8	Rregullorja per Taksa dhe tarifa ndertimore Kuvendit të Komunës	Taksat administrative per leje ndertimi , leje rrenimi dhe tarifat dhe tarifat per ndërtim	Lipjan	Miratuar
9	Te dhena sipas kërkeses së ASK	Plotesimi I Formulit TM4 per periudhen 3 mujore vitin 2019	Lipjan	Finalizuar
10	Të dhëna sipas kërkesës së MEA	Pyetësori për procesin e legalizimit	Lipjan	Finalizuar
11	Të dhëna për inf.sipas kërkesës	Matja e Performancës financiare ne Komunitet e Kosoves – rast studimi Komuna e Lipjanit	Lipjan	Finalizuar
	Pjesemarrja ne trajnim/INDEP	Trajnim online I organizuar nga INDEP - Klubit të Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ): Edicioni i Kosovës	Lipjan	Finalizuar
	Pjesemarrja ne Seminar/MEA Legalizimi	Udhëzuesi për regjistrimin e ndertimeve pa leje – Databaza / seminar online	Lipjan	Finalizuar
	Pjesemarrja ne Seminar/MAP	Sistemi I menaxhimit te performances komunale / seminar online	Lipjan	Finalizuar
12	Takim konsultativ me ATK	Mundësia e krijimit te platformes online dhe pergaditja e materialit lejet ndertimore 2017, 2018, 2019.	Lipjan	Finalizuar
13		Menaxhim i projektit , Renovimi i nyjeve sanitare ne Janjeve	Janjeve	Finalizuar
14		Renovimi i objektit të pensionistëve në Janjevë	Janjevë	Finalizuar
15		Riparimi i kulmit të Qerdhes	Lipjan	Finalizuar

16	Menaxhim projekti	Aneks ndërtimi i Shtëpisë me bazë në komunitet	Lipjan	Në proces
15	Pjesëmarrja ne Komisione vleresuese	Vlerësim tenderi ne 4 projekte	Lipjan	Finalizuar

STATISTIKAT

Pranimi dhe Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr i kërkesave te pranuar gjatë vitit 2020	Nr. I kërkesave nga periudha e kaluar	Të Pezulluara	Miratuara	Refuzuara	Të bartura në sektor tjera	Në procedurë
1	Kushte ndërtimore	79	2	3	45	26	-	7
2	Leje ndërtimi	55	10	-	42	16	-	7
3	Leje rrënimi	6	-	-	3	3	-	-
4	Certifikatë perdorimi	10	2	-	2	8	-	2
5	Certifikatë legalizimi/leje legalizimi	123	3	1	67	17	-	33
	Ne liste te pritjes				8			
6	Kërkesa të tjera	303	1	2	249	20	27	6
	Gjithsejt	576	18	6	416	90	27	55

Të hyrat e planifikuara për vitin 2020 janë në vlerë prej 371,032.00€, që i referohet të hyrave të përgjithshme si Taksat per Leje ndërtimi , Taksat për ndërtim të destinimit të tokës, Leje rrënimi, Lejet Mjedisore Komunale dhe Leje Legalizimi.

Janë shqyrtuar gjithsejt 91% e lëndëve të pranuar, dhe janë realizuar të hyra sipas ndarjeve në vijim:

- Leje ndërtimore.....të planifikuara.....219,032.00€ të realizuara 355,284.76€
- Ndririm i destinimit të tokës .. -//- ... 80,000.00€ 37,388.00€
- Leje mjedisore komunale..... -//-30,000.00€..... .. 32,449.63€
- Leje Rrërimi-//-2,000.00€.....313.32€
- Leje Legalizimi-//-.....40,000.00€.....13,707.78€

Gjithsejt të hyra të planifikuara 371,032.00€ të realizuara 439,143.49€ që rezultojnë në realizim dhe tejkalim të buxhetit total të planifikuar.

DISKUTIME PUBLIKE

Gjatë periudhës raportuese DPUMM ka zhvilluar procesin e shqyrtimit publik të Projekt Dokumentit Harta Zonale e Komunës 2021-2029.

Janë zhvilluar gjithësejt 7 prezente publike.

SFIDAT

Situata e Pandemisë dhe Procesi i finalizimit të HZK dhe shqyrtimi i lëndëve.

DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë –Zyra komunale Kadastrale e Komunës së Lipjanit, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët, duke ofruar informacione dhe azhurnime të ndryshme sipas detyrës zyrtare.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Shqyrtimi i kërkesave në të dy sektorët:

- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave ankesave të palëve dhe institucioneve.
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrimin e të drejtave për pronë të paluajtshme.
- Shqyrtimi i kërkesave për historiate, për persona fizik dhe juridik.
- Shqyrtimi i kërkesave nga institucionet si Gjykata dhe institucione tjera
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim në RDPP

- Shqyrtimi i kërkesave për Vendosje të barrës tatimore.
- Shqyrtimi i kërkesave për lirim nga barra tatimore.
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe qregjistrim të hipotekave.
- Shqyrtimi i kërkesave për Qertifikata pronësie
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

STATISTIKAT

SEKTORI I GJEODEZISË:

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në formë tabelare punët e kryera brenda vitit 2020

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Të pranuar	Nga viti paraprak	Gjithsej	Të miratuara	Të refuzuara	Të pezulluara	Gjithsej
553	6	559	557	2	-	559

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT NUK ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Kopje Plani	1.013
2	Konsultime me pale	233

Në tabelën e poshtëshënuar janë paraqitur punët e kryera gjatë vitit **2020**.

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I PUNËS	NR. I LËNDËVE	SHËNIM (vërejtje)
1	Ndarje të parcelave (regjistrim i ndarjeve)	252	në zyrë
2	Punë për shërbimin pronar- juridik	21	në terren
3	Rirregullim kufiri	4	në zyrë
4	Ndërrimi kultures së parcelave	2	në zyrë
5	Matje e objekteve	-	në zyrë
7	Dhënie të produkteve	247	gjeodetëve të licencuar
8	Bashkim i parcelave	12	në zyrë
9	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	15	në terren

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur llojet e punë të kryera në vitin 2020.

Muaji	Regj.ndar	Marrje e produk.	Regj. i pjesve të ndërtesave	Bashkim i parcelave	Ndrrim i kultures	Rirreg kufiri
Janar	23	27		4		
Shkurt	22	17	1	1	1	1
Mars	9	7	1	1		
Prill	10	2	1	1		
Maj	18	6	2	1	1	
Qershor	24	23	1			1
Korrik	19	25				1
Gusht	21	27	1	1		
Shtator	31	37	3	2		
Tetor	30	24	3	2		1

Nentor	23	22	3			
Dhjetor	31	30				

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të hyrat në sektorin e Gjeodezisë në formë tabelare sipas muajve për vitin 2020, ku gjithësej kemi 21,895.00 euro të hyra.:

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2.123€	1.495€	577€	100€	531€	1.405€	1.239€	1355€	3.555€	3374€	3114€	3027€

SEKTORI I KADASTRIT

Më poshtë paraqesim tabelen përmbledhëse të punëve të kryera dhe të hyrat gjatë vitit 2020.

AKTIVITETET	NUMRI I LËNDËVE TË KRYERA	TË HYRAT
Bartje pronësie dhe Hipoteka	1.155	36.387.50€
Çertifikata, vërtetime për raste sociale dhe kopje plani	7.371	32.047.00€
Gjithsejtë:	8.526	68.434.50 €

Gjithsejtë të hyra nga dy sektorët kemi : **21.895.00€ + 68.434.50€ = 90.329.50€**

DSKUTIME PUBLIKE

Takime me Qytetarë kemi pasur me rastin e shpronësimit të projektit Nacional, autorruka Banullë-Gjilan-Dheu i Bardhë si dhe shpronësimeve në rrugën “Termovent – Rruga „Bajram Gashi”

TAKIME TJERA

Takime me palë në të dy sektorët janë të përditshme, nuk kemi orar të caktuar, prandaj qytetarët për çfardo problemi, kanë mundësinë që ti drejtohen zyrës sonë ku mund të marrin njoftime dhe sygjerime të ndryshme.

SFIDAT

Mungesa e shefit të sektorit në Kadastër ka sjellur vështirësi në punën menaxheriale

DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Sipas natyrës së punëve dhe bartësve të aktiviteteve në kuadër të sektorëve të DSHP-së, aktivitetet e kryera gjatë vitit 2020 në raport janë paraqitur në dy forma: në formë të shkruar dhe në formë tabelare.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Në kuadër të përgjegjësiave, detyrave dhe obligimeve që dalin nga Drejtorati, të përcaktuara me Statutin e Komunës dhe aktet tjera normative në fuqi, janë kryer punë dhe aktivitete të përgjithshme sipas planit vjetor të DSHP-së, si dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga subjektet e ndryshme drejtuar DSHP-së.

Aktivitetet e përgjithshme të DSHP-së

- Pranimi, evidentimi, arkivimi dhe zgjedhja e kërkesave të arritura nga qytetarët apo institucionet të tjera,
